# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6044
E martë, 23 qershor 2020
çmimi 0.40 €


## Qeveria themelon Komisionin ekzekutiv për luftimin dhe monitorimin e Covid-19

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", VESEL KRASNIQI FAQE 4-5

# Do t'i mbështesim bizneset që janë prekur nga pandemia



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka bërë me dije se përmes Pakos Emergjente Fiskale do t'i mbështesin bizneset që janë prekur nga pandemia Covid-19. Sipas tij, kjo mbështetje do të bëhet në dy faza. Ai ka thënë se përmes kësaj pakoje synojnë edhe rimëkëmbjen e ekonomisë në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se si minister fokusi i tij do të jetë mbrojtja e konsumatorëve, prodhuesve vendorë dhe mbrojtja e eksportit. Krasniqi ka thënë se si minister do të angazhohet për fuqizimin edhe më të madh të bashkëpunimit me Shqipërinë. Në këtë intervistë, Krasniqi, i cili vjen nga radhët e Nismës Socialdemokrate, ka folur edhe për situatën politike në vend. Ai ka thënë se nuk do të ketë zgjedhje të reja në vend pasi, sipas tij, qeveria e re do të ketë para vetes dy procese të rëndësishme, dialogun Kosovë - Serbi dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19

## OPINION

OPINIONI I KOMISIONIT TË VENECIAS PËR SHQIPËRINË: ZGJEDHJET, KUSHTETUESJA, MEDIA F. 12

Prof. Lisen BASHKURTI



MARRËVESHJA E PAQES SË PËRJETSHME F. 8

Dr. Sc. Salihe SALIHU



## AKTUALE

LISTA E PËRBASHKËT E SHQIPTARËVE NË LUGINË SOLLI REZULTAT TË MIRË F. 3



# VESELI NIS BETEJËN PËR ZBARDHJEN E PROCESIT TË PRIVATIZIMEVE

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka prezantuar të hënën disa prej nismave ligjore me të cilat do të merret nga funksioni opozitar. Veseli ka thënë se fillimisht do ta iniciojnë formimin e disa komisioneve hetimore parlamentare të cilat do të merren me zbardhjen e privatizimeve të pronave publike dhe të çështjeve të tjera të cilat janë duke i shqetësuar qytetarët e Kosovës që nga paslufta FAQE 7

## EKONOMI

HOTI: KEMI PROGRAM TË HOLLËSISHËM PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 9

USAID-I I JEP MBËSHTETJE MINISTRISË SË FINANCAVE PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE F. 9

## KULTURË

EDHE NJË SUKSES TJETËR I SHKRIMTARES BASRIE MURATI-SAKIRI F. 13



## VETËVENDOSJA E DËRGON NË KUSHTETUESE VENDIMIN E THAÇIT PËR SHTYRJEN E ZGJEDHJEVE NË BESIANË DHE MITROVICË TË VERIUT

FAQE 6


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Haradinaj i jep mbështetje delegacionit të Kosovës për takimin e Uashingtonit, por ka tri kushte

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbajtur të hënën një konferencë për medie, në të cilën ka folur për qëndrimin e kësaj partie në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi.

Haradinaj ka thënë se AAK-ja e mbështet delegacionin e Kosovës për takimin e Uashingtonit, i cili do të mbahet më 27 qershor. Por, Haradinaj ka nënvizuar se dialogu duhet t'i respektojë të paktën tri parime. "Sot ju kam ftuar të flas për çështjen e dialogut. AAK-ja vlerëson se Kosova ka definim të qartë për këtë proces, por duhet t'i përmbahemi parimit të integritetit territorial të Kosovës, parimit të karakterit unitar të pushtetit në Kosovë si dhe parimit për respektimin e kushtetutshmërisë. Këto janë tri parime me të cilat ne si Aleancë përkrahim delegacionin e Kosovës në dialog", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se në këtë format të dialogut e përkrah edhe kryeministrin Avdullah Hoti.

Ai ka thënë se gatishmëria e qeverisë për themelimin e këshillit të ekspertëve për dialogun si dhe udhëheqja e dialogut nga ShBA janë garanci shtesë në proces.



# Shkon në 39 numri i të vdekurve me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka njoftuar se një ditë më parë aty ka vdekur tre pacient një 61, 64 dhe 70-vjeçar me koronavirus.

Viktimat është thënë se ka qenë nga Komuna e Prishtinës, Gjilanit e Vushtrrisë dhe kanë pasur edhe sëmundje të tjera shoqëruese.

Gjatë ditës së hënë në këtë Klinikë janë duke u trajtuar 97 pacientë, prej tyre 93 të infektuar me koronavirus. Sipas zyrtarëve të Klinikës, pesë pacientë janë në gjendje kritike, kurse 41 pacientë janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive.

Marrë parasysh të dhënat e fundit, që prej shfaqjes së rasteve të para me koronavirus në Kosovë më 13 mars dhe deri më tani, janë regjistruar 2 216 raste me sëmundjen Covid-19. Prej tyre, 1 047 persona janë shëruar, kurse 39 pacientë kanë vdekur.




# Në Shqipëri vdes edhe një person nga Covid-19

TIRANË, 22 QERSHOR - Në Shqipëri një tjetër person ka humbur jetën pasditen e së hënës, ndërsa kishte rezultuar pozitiv me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se 62-vjeçari gjendej prej dy javësh i shtruar në Spitalin Infektiv, ndërsa prej dhjetë ditësh ishte në terapi intensive. Në ndryshim nga rastet e mëparshme, 62-vjeçari nuk vuante nga sëmundje bashkëshoqëruese.

Ministria e Shëndetësisë iu drejtua sërish qytetarëve duke nënvizuar rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse "pasi, referuar ekspertëve të Institutit të Shëndetit Publik, virusi është i pranishëm, ka transmetueshmëri dhe nuk e ka humbur forcën e tij virusale".

Nga fillimi i pandemisë janë 45 persona që kanë humbur jetën si pasojë e Covid-19. Edhe në spital numri i të shtruarve ka ardhur duke u rritur ditë pas dite. Të hënën, sipas të dhënave të përditësuara, numri i pacientëve shkoi në 82 persona, ku 10 prej tyre janë në terapi intensive dhe një tjetër është i intubuar.

# Maqedonia e Veriut shënon ulje të numrit të rasteve me Covid-19

SHKUP, 22 QERSHOR - Maqedonia e Veriut të hënën ka regjistruar 90 persona të infektuar me koronavirusin e ri, shifër kjo më e ulëta në 15 ditët e fundit, kur infektimet kishin arritur në rreth 200 të prekur në ditë. Ndërkohë, numri i viktimave ka arritur në 247, me 9 raste të vdekjeve që janë regjistruar në 24 orët e fundit. Të vdekurit janë: pesë nga Shkupi, dy nga Tetova, një nga Ohri dhe një nga Gostivari. Sa iu përket të infektuarve, 36 janë nga Shkupi, 13 nga Ohri, 10 nga Struga, ndërsa të tjerët në 10 qytete të tjera.

Në Klinikën Infektive në Shkup janë pranuar 13 pacientë të rinj. Tash numri i përgjithshëm i pacientëve ka arritur në 106 dhe prej tyre 49 janë në kujdes intensiv.

Në spitalin e qytetit janë të shtrirë 132 pacientë dhe 6 prej tyre janë në aparate respiratorë. Instituti i Shëndetit Publik njoftoi se janë regjistruar 48 persona të shëruar që, po ashtu, paraqet shifër të lartë në krahasim me ditët e fundit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, që nga paraqitja e koronavirusit në vend janë testuar rreth 52 mijë persona dhe prej tyre 5 196 kanë dalë pozitivë, nga të cilët 2 975 ende janë aktivë, ndërsa 1 974 janë shëruar. Numri më i madh i të infektuarve është në Shkup, ku janë regjistruar 2 534 raste.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Rritet përfaqësimi i shqiptarëve në parlamentin e Serbisë

# Lista e përbashkët e shqiptarëve në Luginë solli rezultat të mirë

Bashkimi i disa subjekteve politike shqiptare të Luginës së Preshevës në një listë të përbashkët zgjedhore ka dhënë rezultat. Sipas rezultateve preliminare të zgjedhjeve parlamente në Serbi, Alternativa Demokratike Shqiptare ka arritur t'i marrë tre deputetë shqiptarë në parlamentin serb. Kjo fitore e shqiptarëve është përshëndetur nga spektri politik në Kosovë dhe Shqipëri



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Bashkimi i subjekteve politike shqiptare në Luginë të Preshevës, në një listë për zgjedhjet nacionale në Serbi, ka bërë që shqiptarët të arrijnë rezultat historik. Partitë shqiptare të grupuara nën koalicionin Alternativa Demokratike Shqiptare kanë fituar deri tani tri vende në parlamentin serb sipas rezultateve preliminare të publikua nga Qendra Serbe për Zgjedhje të Lira dhe Demokratike (CESID).

Rezultati i arritur nga subjektet politike të shqiptarëve të Luginës është përshëndetur nga përfaqësuesit politikë të Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një shkrim publikuar në "Facebook", ka vlerësuar se shqiptarët do të kenë më shumë deputetë që do të ngrehin zërin për të drejtat e shqiptarëve atje. "Bashkimi i shqiptarëve në Luginën e Preshevës e dha rezultatin e vet. Ata tashmë do të kenë më shumë deputetë që do ta ngrehin zërin për të drejtat e shqiptarëve atje. Bashkërendimi i veprimeve politike jep gjithmonë rezultate dhe Alternativa Demokratike Shqiptare është shembull i mirë për t'u ndjekur nga bashkëkombësit tanë kudo që jetojnë", ka shkruar Thaçi.

Edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka uruar shqiptarët e Kosovës Lindore për rezultatin e arritur në zgjedhjet parlamentare në Serbi. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se çdo herë kur janë bashkuar shqiptarët kanë arritur fitore. "E kaluara e lavdishme e popullit shqiptar ka treguar se sa herë janë bashkuar shqiptarët kanë triumfuar. Kështu është edhe rasti i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Rezultatet zgjedhore në Serbi tregojnë për një fitore të rëndësishme politike, për motrat dhe vëllezërit tanë matanë kufirit. Uroj që ky bashkim i spektrit politik shqiptar t'i sjellë të mira popullatës shqiptare në Luginën e Preshevës", ka shkruar Veseli.

Bashkimi i pesë subjekteve politike shqiptare (PVD, APN, PD, LPD e LR), nën emërtimin Alternativa e Demokratike Shqiptare, është ndihmuar nga ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Gent Cakaj. Më pas, kjo listë është mbështetur nga Shqipëria dhe Kosova.

## Serbët në Kosovë votuan për zgjedhjet e Serbisë

Institucionet e Kosovës kanë lejuar që këto zgjedhje të mbahen në territorin e Kosovës në vendbanimet me shumicë serbe. Në Kosovë misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka mbledhur votat e shtetasve serbë të cilat më pas u dërguan në Vranjë dhe Rashkë për numërim. "Numërimi i votave do të jetë përgjegjësi e Komisionit Zgjedhor të Republikës së Serbisë", ka njoftuar OSBE-ja. Sipas raportit preliminar të ekipeve të OSBE-së, numri i përgjithshëm i votave të mbledhura ka qenë 55 178, që i bie se 57 88 për qind e trupit votues kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës.

### Partia e Vuçiqit fiton 63 për qind të votave

Partia Progresiste Serbe e presidentit serb Aleksandar Vuçiq ka fituar 63 për qind të votave në zgjedhjet parlamentare të së dielës në Serbi. Ky rezultat ka ardhur pas thirrjeve për bojkot të zgjedhjeve nga një aleancë opozitare si dhe nga shqetësimet lidhur me pandeminë e koronavirusit. "Sonte fituam një besim të madh për njerëzit, më i madhi ndonjëherë në Serbi, në kushte kur pakkush besoi dhe morëm një paralajmërim të madh nga njerëzit se duhet të jemi edhe më të përgjegjshëm dhe t'i arrijmë rezultatet më të mira të mundshme", ka deklaruar presidenti serb Aleksandar Vuçiq gjatë një fjalimi pas shpalljes së rezultateve preliminare të zgjedhjeve.

Sipas rezultateve preliminare, partia e dytë është Partia Socialiste me rreth 10.6 për qind të votave. Ndërkaq në vendin e tretë, partia e krahut të djathtë, Lidhja Patriotike Serbe, ka fituar rreth 4 për qind të votave. Ndërkaq, partitë e tjera pjesëmarrëse në zgjedhjet e 21 qershorit kanë dështuar të kalojnë pragun për të hyrë në parlamentin prej 250 vendesh.

Sipas zyrtarëve zgjedhorë, në zgjedhjet në Serbi pjesëmarrja ishte rreth 49 për qind, prej 6,6 milionë qytetarëve me të drejtë vote. Kjo është dalje më e ulët krahasuar me zgjedhjet e mbajtura më 2016, ku pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë 56.7 për qind.

Zgjedhjet në Serbi u mbajtën në kohën e pandemisë së koronavirusit. Qytetarët gjatë procesit të votimit u detyruan të vendosnin maska dhe të mbanin distancë fizike.

## Ministri Selimi: Në procesin e vetingut të përfshihen ShBA-ja, BE-ja dhe Britania

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, ka mbajtur të hënën takimin e parë me grupin e ekspertëve të pavarur për dizajnimin e parimeve udhëheqëse dhe skenarëve të reformës së vetingut.

Në konferencë për media, Selimi ka thënë se gjatë këtij takimi është njoftuar për punën e deritanishme të grupit të ekspertëve të vetingut dhe për disa çështje specifike që kanë të bëjnë me sistemin e llogaridhënies. "Personalisht kam paraqitur qëndrimin tim që në këtë proces të kemi gjithëpërfshirje. Për më shumë, për ne është e rëndësishme që ky proces i llogaridhënies të bashkëdyzohet me hisedarët e tjerë siç janë ShBA-ja, BE-ja, Britania e Madhe dhe të tjerët që kanë kontribuar për një kohë të gjatë në Kosovë", ka thënë Selimi.

I pari i Drejtësisë ka bërë me dije se ka marrë mbështetje edhe nga institucionet e drejtësisë si Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor që të jenë pjesë e një sistemi gjithëpërfshirës. "Pra, nëse kemi gjithëpërfshirje, të gjithë e dinë që kemi objektivitet dhe ky objektivitet duhet të formohet edhe me ato palë që potencialisht nuk mund të pajtohen mes vete, por këto mospajtime dhe gjetja e të vërtetës duhet të diskutohen bashkë", është shprehur Selimi.

Ndërsa zëvendëskryeministri Driton Selmanaj ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për procesin e reformës në drejtësi, duke përfshirë gjithë aktorët relevantë. "Jemi



shumë të përkushtuar që në Kosovë të ketë hapa konkretë në fuqizimin e sundimit të ligjit, fuqizimin e shtetit të së drejtës dhe tashmë jemi në fazën ku do t'i përcaktojmë modelet më të mira se cilat janë ato", ka thënë Selmanaj.

FLET PËR "EPOKËN E RE", VESEL KRASNIQI

# DO T'I MBËSHTESIM BIZNESET QË



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka bërë me dije se përmes Pakos Emergjente Fiskale do t'i mbështesin bizneset që janë prekur nga pandemia Covid-19. Sipas tij, kjo mbështetje do të bëhet në dy faza. Ai ka thënë se përmes kësaj pakoje synojnë edhe rimëkëmbjen e ekonomisë në vend. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se si ministër fokusi i tij do të jetë mbrojtja e konsumatorëve, prodhuesve vendorë dhe mbrojtja e eksportit. Krasniqi ka thënë se si ministër do të angazhohet për fuqizimin edhe më të madh të bashkëpunimit me Shqipërinë. Në këtë intervistë, Krasniqi, që vjen nga radhët e Nismës Socialdemokrate, ka folur edhe për situatën politike në vend. Ai ka thënë se nuk do të ketë zgjedhje të reja në vend pasi, sipas tij, qeveria e re do të ketë para vetes dy procese të rëndësishme, dialogun Kosovë - Serbi dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

Prishtinë, 22 qershor -

**"Epoka e re"**: *Z. Krasniqi, cilat janë objektivat e juaja në mandatin e ministrit të MTI-së?*

**Krasniqi:** Jam i vetëdijshëm për rëndësinë që ka MTI-ja, sidomos tani në kohën e pandemisë Covid-19. Synojmë t'i mbështesim bizneset me Pakon Emergjente Fiskale, gjithashtu edhe rimëkëmbjen e ekonomisë. Mund t'jua konfirmoj se jemi në përfundim e sipër të programit për rimëkëmbjen ekonomike. Po ashtu, fokusi im në këtë mandat do të jetë mbrojtja e konsumatorëve vendorë, mbrojtja e prodhuesve vendorë dhe mbrojtja e eksportit.

**"Epoka e re"**: *Kishte vërejtje për pakon emergjente, ndërkohë ju thoni se jeni në përfundim të një platforme. Çfarë dallon kjo platformë nga ajo e qeverisë Kurti?*

**Krasniqi:** Mbështetjen e bizneseve e kemi planifikuar në dy faza. Pakoja ka filluar me qeverinë Kurti dhe ne tashmë e kemi modifikuar atë, sepse kemi trashëguar obligime të cilat nuk janë zbatuar nga qeveria Kurti, duke filluar nga shuma prej 170 eurosh për pagesën e dytë për punëtorët e sektorit privat. Prandaj, që në fillim kemi planifikuar rishikimin e buxhetit sepse pa rishikim të buxhetit as programin për rimëkëmbje të ekonomisë nuk do të mund ta realizojmë. Ne planifikojmë që me këtë pako më t'i shpenzojmë 180 milionë euro dhe do t'i mbështesim kryesisht bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat gjatë pandemisë nuk kanë mundur ta ushtrojnë veprimtarinë e vet. Çështja tjetër që jemi në përfundim e sipër është pakoja për rimëkëmbjen ekonomike.

**"Epoka e re"**: *Keni nxjerrë një udhëzim administrativ sa i përket çështjes së gastronomisë, respektivisht mbajtjes së distancës, por ky vendim nuk po zbatohet. Sa është numri i inspektorëve të angazhuar?*

**Krasniqi:** Këtë udhëzim administrativ e kam nxjerrë duke pasur parasysh numrin e të infektuarve me Covid-19 ditët e fundit. Në këtë drejtim kemi kërkuar që të mbahet distancë. Ne kërkojmë nga bizneset që ta respektojnë këtë vendim, gjithashtu edhe nga qytetarët, sepse nuk kemi mundësi të rrimë 24 orë në secilin lokal. Po për këtë çështje obligohen që ta monitorojnë situatën edhe inspektorët që janë në kuadër të komunave. Gjithashtu, kemi planifikuar ta rrisim numrin e inspektorëve në përgjithësi, që ta luftojmë ekonominë informale, sepse kjo është kërkesë edhe e Bashkimit Evropian.

**"Epoka e re"**: *Sa inspektorë planifikoni që t'i shtoni?*

**Krasniqi:** Ne nuk japim shifra sikurse Lëvizja Vetëvendosje dhe më pas të dalim qesharakë. Ne synojmë që brenda mandatit tonë ta rrisim dukshëm këtë numër.

**"Epoka e re"**: *Për turizmin keni pasur një takim me homologun tuaj nga Shqipëria, Blendi Klosi, si pritet të jetë bashkëpunimi me Shqipërinë dhe vendet e tjera si Malin e Zi?*

**Krasniqi:** Ne kemi pasur takim edhe me kryetarin e Ulqinit

# JANË PREKUR NGA PANDEMIA



dhe jemi pajtuar që të bashkëpunojmë, gjithmonë duke marrë parasysh instruksionet e institucioneve gjegjëse dhe me masat preventive që ne synojmë t'i praktikojmë. Sa i përket takimit me ministrin Klosi, jemi pajtuar që ta bëjmë hapjen sezonale në fillim të korrikut dhe, po ashtu, jemi pajtuar që në vjeshtë të bëjmë një hapje sezonale për turizmin në Kosovë, pasi vendi ynë shquhet me bjeshkë dhe bukuri të tjera natyrore. Po ashtu, jemi pajtuar ta krijojmë një platformë të përbashkët me pikat turistike nga të dyja vendet dhe këtë platformë ta shpalosim në shtetet e tjera evropiane, në mënyrë që të funksionojmë si ekipe.

**"Epoka e re":** *Kemi një paralajmërim për ngritje të çmimit të naftës. Po ashtu, naftëtarët kanë kërkuar uljen e çmimit për kalibrim. Si qëndron puna në këtë sektor?*

**Krasniqi:** Që në fillim të marrjes së detyrës së ministrit kam zhvilluar takim me 20 përfaqësues të naftëtarëve dhe i kam dëgjuar shqetësimet e tyre. Ky dikaster është nga veprimtaritë më të ndjeshme në Kosovë. Por, ajo çfarë themi para jush dhe para qytetarëve, i siguroj konsumatorët për cilësi, për faktin se kontrollet e naftës bëhen në kufi. Pra, nafta nuk mund të hyjë pa i përfillur standardet e Bashkimit Evropian. Pastaj kemi edhe inspektimet e brendshme. Kemi një udhëzim administrativ që nuk është zbatuar, të cilin e kam gjetur në sirtarë të kësaj ministrie. I siguroj qytetarët dhe naftëtarët se këtë udhëzim do ta zbatoj, pasi është përpiluar me ligjin aktual. Kam kërkuar nga Qeveria e Kosovës që me anë të këtij udhëzimi të sigurohen ndryshime të tjera që do të jenë në favor për konsumatorët dhe për naftëtarët. Sot kam nënshkruar një vendim për shtyrje të afatit për licenca të cilave u ka skaduar afati gjatë kohës së pandemisë sepse nuk kanë mundur të aplikojnë. Pra, është e padrejtë që inspektori të shkojë dhe t'i gjobisë. Me anë të nxjerrjes së këtij vendimi e kam shtyrë afatin deri më 24 korrik.

**"Epoka e re":** *Sa është numri i bizneseve të regjistruara dhe të shuara gjatë kohës së pandemisë?*

**Krasniqi:** Nga statistikat që kam marrë, kemi një numër të vogël të shuarjes së bizneseve dhe kemi numër të madh të regjistrimit. Këto shifra janë të raporteve javore. Nga 15 marsi ende nuk i kemi të dhënat. Besoj se së shpejti dalim me statistika të sakta. Në opinion flitet shumë që janë dëmtuar bizneset, por ka më shumë biznese të regjistruara sesa të shuara. Qeveria do t'i mbështesë bizneset, edhe ato biznese që nuk u është paguar qiraja nga qeveria Kurti. Me rishikimin e buxhetit do t'ua paguajnë edhe qiranë edhe pagat. Po ashtu, ka mundësi edhe për shtyrje të kësteve të kredive me anë të vendimeve të BQK-së, si dhe çështja e Trustit për tërheqjen e mjeteve individuale.

**"Epoka e re":** *Kishte vërejtje për Ligjin për Investime Strategjike. Do të merrni iniciativë për amendamentim të këtij ligj, si dhe çfarë iniciativash të tjera do të dërgoni në qeveri?*

**Krasniqi:** Ne kemi 15 biznese që kanë aplikuar për ta marrë titullin e investitorit strategjik por, për shkak të vakuumeve institucionale, nuk kanë arritur që të shqyrtohen kërkesat e tyre në komisionin ndërministror. Në këtë javë besoj se do ta procedoj në qeveri propozimin që të formohet komisioni ndërministror në kuadër të MTI-së që do të merret me shqyrtimin e këtyre kërkesave. Kemi kërkesa nga jashtë dhe nga brenda, pra është e rëndësishme që këtyre mos t'u humbë e drejta për të investuar. Këtë ligj do ta shtyjmë përpara dhe do ta zbatojmë.

**"Epoka e re":** *Për cilët sektorë ka më shumë kërkesa?*

**Krasniqi:** Kryesisht kërkesat janë për bizneset prodhuese. Ka kërkesa në sektorin e energjisë, në përpunimin e produkteve bujqësore dhe për Kosovën e Re, por kjo kërkesë ka kaluar te MZhE-ja.

**"Epoka e re:** *Sa i përket qeverisë Hoti, a jeni optimist se koalicioni do ta çojë deri në fund këtë mandat?*

**Krasniqi:** Është shumë interesant se sa shpesh përmenden numrat. Ne e patëm qeverinë Kurti me numër të madh të votave, por me numër të vogël të ditëve të qeverisjes, pasi ajo qeveri zgjati vetëm 51 ditë. Qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike, janë lodhur me vakum institucional dhe, si rrjedhojë, jemi në një gjendje jo të mirë. Prandaj, qeveria e tashme e ka mbuluar këtë vakum. Tani kemi çështjen e dialogut dhe është proces mjaft i vështirë. Mendoj se pa u përfunduar kjo çështje dhe pa kaluar pandemia nuk do të ketë zgjedhje. Nëse ekziston gjë e tillë do të shkatërrohet vendi. Sado që opozita do të jetë kritike, jam i sigurt se edhe opozita do të jetë e arsyeshme në këtë aspekt.

**"Epoka e re:** *Cilat janë pritjet e juaja nga takimi në Uashington më 27 qershor, meqë është thënë se do të flitet edhe për çështje ekonomike?*

**Krasniqi:** Nisma Socialdemokrate ka qëndrimin e vet në lidhje me këtë proces dhe ne qëndrojmë pas këtij qëndrimi se nuk ka lëvizje të kufijve të cilët i kemi të garantuar me Kushtetutë dhe nuk ka kompromis. Me përfundimin e dialogut do të shohim një të ardhme shumë të mirë dhe një zhvillim ekonomik, për faktin se shumë investitorë të jashtëm nga Evropa dhe ShBA-ja kanë hezituar të bëjnë investime për shkak të jostabilitetit politik. Sapo të zgjidhet kjo çështje do të kemi një siguri më të madhe si dhe do të kemi investitorë që drejtpërdrejt do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

## Qeveria themelon Komisionin ekzekutiv për luftimin dhe monitorimin e Covid-19

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar mbledhjen e shtatë të rregullt, në të cilën ka miratuar disa vendime dhe dokumente të politikave qeveritare nga fushat e përgjegjësive të saj kushtetuese dhe ligjore. Në këtë mbledhje qeveria ka themeluar Komisionin ekzekutiv për luftimin, monitorimin dhe reagimin ndaj Covid-19. Ky komision ka për qëllim ta shqyrtojë dhe informojë qeverinë për çështje të caktuara në lidhje Covid-19, të këshillojë dhe t'i propozojë qeverisë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për luftimin e këtij virusi. Komisioni në fjalë përbëhet nga 21 anëtarë dhe do të kryesohet nga këshilltari i kryeministrit Hoti, Visar Berisha.

Po në këtë mbledhje është emëruar edhe Komiteti për partneritet publiko-privat në përbërje të anëtarëve të përhershëm të ministrave të dikastereve qeveritare. Gjithashtu, qeveria ka miratuar vendimin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave të Reformës së Administratës Publike si dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjisë së reformës së administratës publike. Këshilli i Ministrave për Reformën e Administratës Publike do të kryesohet nga ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu.

Me vendime të veçanta, kabineti qeveritar ka ricaktuar në pozitat e sekretarëve të përgjithshëm: Burim Rrecin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Izedin Bytyqin në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Lulzim Ejupin në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në mbledhjen e qeverisë Hoti, Bujar Ejupi është emëruar në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa Ekrem Kastrati në pozitën e kryeinspektorit të punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Me vendimin e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ardijan Bujupit i është vazhduar mandati i anëtarit të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nga Ministria e Drejtësisë.



# 22 vjet burgim për Darko Tasiqin për krime lufte në Krushë të Vogël

**Prizren, 22 qershor (ER)** - Me 22 vjet burgim është dënuar Darko Tasiq për krime lufte në Krushë të Vogël në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Darko Tasiq është shpallur fajtor në dy pika të aktakuzës. "Në mes të datave 15-26 mars të vitit 1999, në Krushë të Vogël, në cilësinë e pjesëtarit të forcave rezervë të Policisë të Republikës Federative të Jugosllavisë apo forcave paraushtarake serbe, në bashkëkryerje me persona të tjerë, identiteti i të cilëve nuk është arritur të përcaktohet, mori pjesë në konfiskim të pasurisë, plaçkitje, shkatërrim të paligjshëm dhe të qëllimshëm të pasurisë (djegien e shtëpive) që nuk justifikohej me nevojat ushtarake", është thënë në pikën e parë të aktakuzës ndaj Tasiqit. Ndërsa në pikën e dytë, Tasiqi ngarkohej edhe me veprime të tjera si pjesëmarrje në përdhosjen e trupave të pajetë të personave të paidentifikuar, duke i djegur ato dhe duke i hedhur në lumin Drin.

Kundër këtij vendimi është shprehur kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati, i cili ka thënë se një dënim i tillë është shumë i vogël. Aktgjykimi ndaj Darko Tasiqit për krime lufte është përcjellë me protesta nga ana e familjarëve të viktimave të Krushës së Vogël, madje ata, siç ka njoftuar Shërbimi Korrektuese i Kosovës, e kanë sulmuar veturën e Njësisë për Përcjelljen e të Burgosurve e Burgut të Sigurisë së Lartë e cila po e barte Tasiqin.




# Vetëvendosja e dërgon në Kushtetuese vendimin e Thaçit për shtyrjen e zgjedhjeve në Besianë e Mitrovicë të Veriut

EPOKA E RE *Qendresa RAMA*

**Prishtinë, 22 qershor** - Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të presidentit Hashim Thaçi për shtyrjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Besianës dhe të Komunës së Mitrovicës së Veriut. "Me vendimet e presidentit, për të shtyrë pa afat të caktuar mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Besianës, së fundi edhe për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, presidenti ka privuar qytetarët nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur siç përcaktohet me nenin 45 të Kushtetutës. Vendimi i presidentit për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve në Besianë dhe Mitrovicë është në kundërshtim me Kushtetutën e



Republikës si dhe në kundërshtim me konventat ndërkombëtare të integruara në Kushtetutë si dhe me praktikat e mira dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale", ka njoftuar Vetëvendosje. Kjo lëvizje ka theksuar se nga 6 shkurti i këtij viti qytetarët e Komunës së Besianës vazhdojnë të privohen nga e drejta e tyre e përcaktuar me Kushtetutë për ta zgjedhur përfaqësuesin e tyre si kryetar të komunës si dhe për ta pasur qeverisjen lokale që e kanë zgjedhur përmes zgjedhjeve të lira, me justifikimin se ato rrezikojnë shëndetin publik. "Dje u organizuan zgjedhjet e Serbisë në Kosovë dhe me këtë rast ky justifikim ka rënë poshtë plotësisht. Sepse si mund të shpjegohet që zgjedhjet e Serbisë mund të organizohen, kurse ato të vetë komunave të Kosovës jo. Cila është porosia? Që ne kemi më pak të drejta? Që minoriteti serb nuk është përgjegjësi e qeverisë sonë sa i takon shëndetit publik? Cilado qoftë arsyeja, është skandaloze dhe e papranueshme. Kushtetuta e Republikës, si dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, garantojnë të drejtën e patjetërsueshme për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës e cila gëzon shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajon e siguron pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale", ka njoftuar Vetëvendosje, duke shtuar se gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. "Këto të drejta kushtetuese të qytetarëve mundësohen përmes shpalljes dhe organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të drejtpërdrejta. Askush nuk ka të drejtë e autorizime, aq më pak presidenti, që arbitrarisht dhe jashtë kompetencave të tij ta pamundësojë ushtrimin dhe përmbushjen e këtyre të drejtave përmes shtyrjes pa afat të mbajtjes së zgjedhjeve për kryetar të komunës. Përkundrazi, përgjegjësia kushtetuese dhe ligjore e presidentit është caktimi i datës së zgjedhjeve në afatet e përcaktuara me ligj. Pas dorëheqjes së kryetarit të komunës, zgjedhjet e parakohshme lokale shpallen nga presidenti i Kosovës. Zgjedhjet e parakohshme shpallen jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas dorëheqjes, të cilat nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas shpërbërjes", ka njoftuar subjekti politik që drejtohet nga Albin Kurti.

## Selimi: Rritja e numrit të noterëve nënkupton edhe rritje të kritereve kualifikuese

**Prishtinë, 22 qershor** - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi është takuar të hënën me kryetarin e Odës së Noterëve, Aliriza Beshi dhe kryetarin e Odës së Ndërmjetësuesve Faton Morina. Gjatë këtyre takimeve të ndara, ministri Selimi ka thënë se është e nevojshme të fuqizohen dhe të kenë mbështetje profesionet e lira meqë, sipas tij, qytetarët e Kosovës duhet të kenë shërbime të shpejta dhe efikase.

Ministri Selimi ka thënë se përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve nënkupton edhe shtrirjen e noterëve në tërë territorin e vendit. "Rritja apo shtrirja e numrit të noterëve në gjithë territorin e Kosovës nënkupton edhe rritje të kritereve kualifikuese për shkak se prioriteti ynë mbetet ngritja e efikasitetit të punës dhe rritja e kredibilitetit në fushën e noterisë", është shprehur ministri Selimi.

Rëndësi të veçantë, sipas ministrit Selimi, është edhe rritja e kapaciteteve dhe numri i ndërmjetësuesve që, sipas tij, do të mundësojnë zgjidhje të shpejta, efikase dhe me kosto të ulët për disa lloje të çështjeve për të cilat qytetarët rëndomë kanë pritur me vite në procese gjyqësore. Ndërsa kryetarët e dy odave falënderuan ministrin Selimi për bashkëpunim duke vlerësuar se profesionet e lira në Kosovë janë në rrugën e duhur për konsolidim të plotë.



# Veseli nis betejën për zbardhjen e procesit të privatizimeve

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka prezantuar të hënën disa prej nismave ligjore me të cilat do të merret nga funksioni opozitar. Veseli ka thënë se fillimisht do ta iniciojnë formimin e disa komisioneve hetimore parlamentare të cilat do të merren me zbardhjen e privatizimeve të pronave publike dhe të çështjeve të tjera të cilat janë duke i shqetësuar qytetarët e Kosovës që nga paslufta. “PDK-ja do të ndërmarrë veprime konkrete kushtetuese e ligjore brenda Kuvendit të Kosovës për këto tema, të cilat do t’i shërbejnë vetëm interesit publik dhe nxjerrjes së të vërtetës një herë e përgjithmonë se kush janë abuzuesit e vërtetë me emër e mbiemër të këtij vendi”, ka thënë Veseli




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në një konferencë për media ka prezantuar nismat ligjore që do të ndërmarrë kjo parti për të zbardhur të vërtetën e plotë që nga procesi i privatizimit e deri te të gjitha çështjet jetike për vendin në 21 vjet liri. Ai ka thënë tani do të nisë ballafaqimi me të vërtetën për shumë tema e vendime që janë përfolur e abuzuar politikisht përgjatë 20 vjetëve. “Prandaj, PDK-ja do të ndërmarrë veprime konkrete kushtetuese e ligjore brenda Kuvendit të Kosovës për këto tema, të cilat do t’i shërbejnë vetëm interesit publik dhe nxjerrjes së të vërtetës një herë e përgjithmonë, se kush janë abuzuesit e vërtetë me emër e mbiemër të këtij vendi. Këto iniciativa nënkuptojnë themelimin e komisioneve hetimore për çështje me rëndësi të veçantë për publikun, si dhe propozime për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve aktuale, duke përfshirë këtu edhe iniciativat e reja legjislative hetimore dhe gjithçka që u mundësohet hetimeve parlamentare të pavarura e profesionale”, ka thënë Veseli në një konferencë për medie

Lideri i PDK-së ka thënë se nga këto veprime konkrete dhe iniciativa parlamentare nuk do ta përjashtohet asnjë individ politik, qoftë edhe brenda partisë që drejton. “Prandaj, kërkesa e parë që e deponojmë këtë javë në Kuvendin e Kosovës është për themelimin e komisionit hetimor parlamentar për procesin e privatizimit në Kosovë. Dua t’i siguroj të gjithë qytetarët e ndershëm të këtij vendi, ndërmarrësit e bizneset, që ky proces nuk është kundër tyre si dhe kundër procesit të privatizimit. Përkundrazi, si parti e qendrës së djathtë e mbështesim dhe do të angazhohemi që këtij procesi t’i sigurojmë transparencë të plotë dhe llogaridhënie deri në fund”, ka thënë Veseli, duke shtuar se PDK-ja është e përkushtuar ta mbrojë interesin e qytetarëve të Kosovës. “Partia Demokratike e Kosovës, si parti opozitare dhe unë si kryetar i saj, jemi të përkushtuar për ta përfaqësuar dhe mbrojtur interesin e qytetarëve dhe të Kosovës në mënyrën sa më të mirë.

Mesazhin e qytetarëve të dhënë në zgjedhjet e 6 tetorit ne si parti e kemi kuptuar drejt dhe po punojmë çdo ditë për të krijuar shanse e mundësi të barabarta për secilin; ku ligji të mbron dhe të jep mundësi; ku nuk abuzohet dhe nuk ka vend për krim e korrupsion. E kam dhënë fjalën dhe po punoj e angazhohem çdo ditë ta mbaj çdo premtim timin. Prandaj, javën që shkoi unë prezantova në Prizren rrugëtimin e ri të PDK-së për rimëkëmbjen kombëtare, ku zë vend shteti i së drejtës, ku koncepti modern ekonomik në parimin djathtist të tregut dhe konkurrencës së lirë janë parimet orientuese tona. Për mua si kryetar dhe për PDK-në, interesi i qytetarëve dhe mbrojtja e Republikës kudo dhe kurdo, pavarësisht të qenit në pushtet ose në opozitë, janë përmbi çdo fat individual të politikanëve apo partie politike”, është shprehur Veseli.

Më tutje, ai ka thënë se këto tema kanë qenë një shqetësim real dhe i drejtë i qytetarëve të Kosovës. “Nga këto veprime konkrete e iniciativa parlamentare nuk do ta përjashtohen as individë brenda partisë time. Sot nis një epokë e re për qytetarët e Kosovës; për të mirën e interesit publik; mbrojtjen e pasurisë së këtij vendi dhe të vërtetat e privatizimit të ndërmarrjeve publike e shoqërore - për të cilat është abuzuar politikisht në mënyrë të paskrupullt. Shpeshherë njerëzit më të përfolur në këto procese kanë qenë zhurmaxhinjtë më të mëdhenj”, është shprehur Veseli, duke shtuar se në ditët dhe javët në vazhdim PDK-ja do të iniciojë edhe iniciativa të tjera parlamentare në Kuvendin e Kosovës që janë në interes të qytetarëve dhe të Kosovës. “Si PDK kemi pritur që, duke qenë në opozitë, t’i ndërmarrim këto iniciativa parlamentare, që askush të mos dyshojë apo ankohet se duke qenë në pushtet, PDK-ja do t’i kontrollonte këto tema apo hetimet për to. Ne sot jemi në opozitë. I ftoj për bashkëpunim të gjithë, veçmas qytetarët e Kosovës dhe partitë politike që t’i mbështesin këto iniciativa për ta zbardhur të vërtetën dhe të gjithë ata që abuzuan politikisht dhe i keqpërdorën për përfitime politike”, ka deklaruar Veseli.

# Finlanda ofron përkrahje për Kosovën

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall. Në njoftimin e qeverisë thuhet se gjatë takimit u diskutua mbi gjendjen aktuale në menaxhimin dhe parandalimin e pandemisë me Covid-19 si dhe për masat që po i ndërmerr qeveria me qëllim rimëkëmbjen e ekonomisë në vend, dialogun Kosovë - Serbi, që nënkupton njohjen reciproke mes dy vendeve, forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit dhe procese të tjera të rëndësishme për shtetin e Kosovës.

Ndër të tjera, kryeministri Hoti ka thënë se Finlanda në vazhdimësi e ka ndihmuar Kosovën në programe të caktuara që kanë pasur rëndësi të veçantë për jetën e qytetarëve dhe për këtë u jemi shumë mirënjohës, duke shtuar se marrëdhëniet e Kosovës me Finlandën kanë qenë gjithmonë miqësore. Ndërkaq ambasadorja Pia Stjernvall ka shprehur gatishmërinë e Finlandës për t’i ofruar ndihmë shtetit të Kosovës në ngritjen dhe përgatitjen e kapaciteteve për arritjen e objektivave të saj.



# MARRËVESHJA E PAQES SË PËRJETSHME

*"Asnjë traktat apo marrëveshje paqeje nuk do të jetë e vlefshme kur ka një çështje/lëndë të rezervuar në heshtje për një luftë në të ardhmen".*



Dr. Sc. Salihe SALIHU

Në shumë procese për mirëmbajtjen e rendit paqësor është e domosdoshme ndihma e ndërkombëtarëve. Në veçanti ndërkombëtarët mund të kontribuojnë që të ruhet paqja nga pretendimet me interesa kontrandiktore dhe konfliktoze në mes të shteteve.

Një proces i këtillë tani është shfaqur nga aktualiteti i çështjes së Kosovës në të cilën kërkohet një koordinim ndërkombëtar për ta ruajtur paqen dhe qëndrueshmërinë në këtë rajon. Ekziston arsyeja e fuqishme që të përqendrohemi se në çfarë sfondi duhet të vazhdohet ky proces për ta realizuar arritjen e një marrëveshje paqësore.

Në këtë proces që është stërzgjatur tej mase tani janë aktivizuar ndërkombëtarët në dy pole me mision ndërmjetësues. Poli evropian dhe poli amerikan kanë ndezur motorët e tyre për ta marrë përsipër zgjidhjen e konfliktit të ngrirë mes shteteve, Serbisë dhe Kosovës. Këto dy shtete sovrane janë mirë të njohura nga ndërkombëtarët jo vetëm si shtete, por edhe për të kaluarën e tyre të përgjakshme. Ndonëse lufta ka marrë fund, problemet dhe mosmarrëveshjet e tyre po vazhdojnë të krijojnë situatë luftënxitëse.

Në të vërtetë, dihet se pretendimet e Serbisë janë armiqësore dhe kërkojnë shembjen e sovranitetit të Kosovës derisa kjo e fundit është në kërkim të një paqe të përjetshme. Po në çfarë premise mund të arrihet paqja e përjetshme. Pikërisht për paqe të përhershme ekziston edhe libri me titull "Paqja e përjetshme" nga Immanuel Kant, në të cilin për arritjen e paqes së përjetshme janë specifikuar tri parime të domosdoshme: kushtetutë civile/qytetare, ndalim i dhunës dhe liria e njeriut si qytetar i botës. Nga këto tri parime, dy të parat, duke u rezervuar për të tretën, mund të shihen më konkretisht në momentumin për marrëveshjen e shumëpritur në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Si mund të interpretohen dy parimet kantiane në rastin e Serbisë dhe Kosovës për të arritur një marrëveshje me paqe të përjetshme?

Në pikën e parë, kushtetutë civile/qytetare si kriter për paqe të përjetshme tingëllon qartë semantika e tij. Nga vetë definimi i parimit na bën të kuptojmë se ky parim nënkupton që kushtetuta të ketë përmbajtje demokratike. Në këtë këndvështrim duhet shikuar modelimi i kushtetutës. Teksti i kushtetutës duhet të jetë si pikënisje për ecje përpara për ndryshimet thelbësore të cilat do të prodhojnë ligje dhe rregullore që do të jenë të justifikueshme për zbatim dhe do ta kontribuojnë arritjen e marrëveshjes.

Analizuar nga ky këndvështrim, rrjedhimisht del se kushtetutat e dy shteteve të jenë me tekst që frymon demokraci. Kushtetutat demokratike duhet të jenë të qarta dhe në mbështetje të normave ekzistuese ndërkombëtare që i mirëmbajnë relacionet mes dy shteteve dhe që garantojnë paqe.

Mbi këtë bazë bëhet formësimi dhe rregullimi i ligjeve të dy shteteve që do t'i edukonte shtetasit e tyre që të mendojnë e veprojnë në frymë demokratike. Me fjalë të tjera, një modelim i kushtetutës demokratike prodhon veprime të bazuara në parime etike.

Në këtë drejtim ndërkombëtar duhet të kërkojnë nga Serbia që ta ndryshojë Kushtetutën e saj jo vetëm në lidhje me Kosovën, por edhe për çështjen e minoritarëve që jetojnë atje. Në përgjithësi të drejtat e minoritarëve, në veçanti të minoritarëve shqiptarë të cilët janë skajshmërisht të diskriminuar. Nuk mund të ketë paqe në rajon kur shqiptarët atje nuk gëzojnë të drejta dhe keqtrajtohen nga regjimi serb. Mbetja e minoritarëve shqiptarë në Serbi jashtë agjendës për Marrëveshjen Paqësore është e ngjashme me mospërfshirjen e fatit të shqiptarëve të Kosovës në marrëveshjen e Dejtonit.

Ky injorim i fatit të minoritarëve në Serbi do të jetë gabim i madh nga ana e ndërkombëtarëve. Por, ky gabim nuk duhet të lejohet të ndodhë pasi që do të prodhojë konsekuenaca negative jo vetëm për minoritetin shqiptar në Serbi, por pasojat do t'i bartën në gjithë rajonin.

Sipas mësimeve nga gjashtë kriteret kantaniane është: "Asnjë traktat apo marrëveshje paqeje nuk do të jetë e vlefshme kur ka çështje/lëndë të rezervuar në heshtje për një luftë në të ardhme".

Në anën tjetër, në Kushtetutën e Kosovës duhet të bëhen ca ndryshime që shteti sovran i Kosovës të jetë funksional. Për çështje vitale të shtetit nuk mund të vendosin minoritarët, votat e 2/3 të minoritarëve, sepse në asnjë vend demokratik nuk ekziston ky privilegj. Korrigjimi i këtij neni është i domosdoshëm pasi që kjo është pengesë për funksionalizim shtetëror dhe efektivizim në procese zhvillimore. Në fakt, kjo formë e privilegjeve shndërrohet në hendek të rrezikshëm dhe bllokadë zhvillimore për shtetin e Kosovës.

Pa rishikimin e këtyre dy kushtetutave të shteteve respektive nuk mund të arrihet ndonjë frymëmarrje demokratike që do të prodhonte marrëveshje paqësore të përjetshme. Nëse injorohen këto parakushte, atëherë çdoherë do të mbetet mundësi për infektime armiqësore të mëvonshme ndërmjet shteteve të cilat mund ta luhatin paqen. Prandaj, rishikimi i kushtetutave të dy shteteve që pretendojnë të arrijnë paqe është i domosdoshëm dhe duhet që teksti i tyre të jetë i identifikuar me parimet e demokracisë e jo me ngufatjen e tyre.

Në interpretim të parimit të dytë është ndalimi i dhunës. Në rastin e Serbisë dhe Kosovës përdorimi i dhunës në mënyrë të hapur është ndërprerë, mirëpo a është kjo e mjaftueshme për ta arritur paqen e përjetshme? Mendoj se paqja e përhershme apo e përjetshme mund të arrihet kur të fshihet nga mendja çfarëdo pretendimi apo ushqimi që kanë ingredienca helmuese. Asnjëri shtet nuk duhet ta prekë sentimentin nacional apo ta ushqejë ndonjë ndjenjë që mund të nxisë dhe shkaktojë rikthim të kërcënimeve dhe dhunës. Edhe në këtë fushë shtetet duhet të zotohen se do ndjekin një diskurs paqësor ndaj njëra-tjetrës në çdo fushë: politike, diplomatike, edukativo-arsimore, historike, sociale etj.

Nëse marrëveshja do të shkruhet mbi parakushtet e lartshënuara atëherë mund të presim që pikat e tjera të marrëveshjes do të pushonin pikërisht mbi sfondin e parimeve të lartpërmendura që duhet të jenë parakusht për përafrim të këtyre shteteve drejt një Marrëveshje Paqësore të Përjetshme.



## USAID-i i jep mbështetje Ministrisë së Financave për menaxhimin e financave publike

Prishtinë, 22 qershor (ER) - Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën në takim drejtoreshën e USAID-it, Lisa Magno, me të cilën ka diskutuar për Programin për Rimëkëmbje Ekonomike të Qeverisë së Kosovës dhe për aktivitetet e tjera të kësaj ministrie në funksion të nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe avancimit të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në projekte të ndryshme ekonomike.
Ministrja Bajrami e ka informuar Magnon për punën e Ministrisë së Financave në adresimin e sfidave që kanë të bëjnë me rimëkëmbjen ekonomike dhe për ruajtjen e stabilitetit makrofiskal dhe e ka falënderuar atë për mbështetjen e vazhdueshme të USAID-it në shumë projekte të cilat kanë ndihmuar dhe po e ndihmojnë Ministrinë e Financave. Ndërsa Lisa Magno e ka uruar ministren Bajrami për pozitën e re dhe ka shprehur gatishmërinë e saj dhe të USAID-it për ta vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Financave në fushën e menaxhimit të financave publike si dhe në tejkalimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19.



# Hoti: Kemi program të hollësishëm për rimëkëmbjen ekonomike

EPOKA E RE Qendresa RAMA



Prishtinë, 22 qershor - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në kuadër të prezantimit të masave të Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike si pjesë e programit qeverisës, të hënën ka marrë pjesë në forumin virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Në fjalën hyrëse kryeministri Hoti ka prezantuar prioritetet e qeverisë, masat që janë ndërmarrë për menaxhimin e situatës së shkaktuar si pasojë e pandemisë Covid-19 si dhe për çështje të tjera që ndërlidhen me aktualitetin politik dhe ekonomik në vend.
Kryeministri Hoti ka thënë se orientimet e qeverisë janë në dy aspekte kohore në periudhë të shkurtër dhe afatmesme përmes pakos për Rimëkëmbje Ekonomike dhe në periudhë më afatgjatë ku do të vendosen bazat e zhvillimit ekonomik.
Më tej, kryeministri Hoti ka pohuar se është me interes që ta krijojnë konsensusin e nevojshëm shoqëror për programin qeverisës të cilin, siç ka theksuar ai, e kanë miratuar në qeveri dhe e kanë shpërndarë te të gjitha aktorët e tjerë. "Fokusi ynë kryesor mbetet rimëkëmbja ekonomike, por përtej asaj ne kemi një program bukur të detajuar nëpër fusha të caktuara të ekonomisë", u shpreh kryeministri Hoti.
Në këtë forum virtual kryeministri Hoti ka thënë se Qeveria e Kosovës do të jetë e fokusuar në zhvillimin ekonomik afatgjatë, ndërtimin e politikave nxitëse për sektorin privat, politikat tatimore, zvogëlimin e informalitetit, themelimin e Fondit Investiv, kompensimin e humbjeve ekonomike të shkaktuara si pasojë e pandemisë si dhe për investimet e jashtme përmes ligjit për investime strategjike.
Kryeministri Hoti me këtë rast ka thënë se qeveria gjatë këtij viti dhe vitit të ardhshëm parasheh futjen në ekonomi të një shume financiare prej 1.2 miliard eurosh si infuzion për zhvillim ekonomik, prej të cilave tashmë me rishikimin e buxhetit janë mobilizuar 384 milionë euro.
Hoti me këtë rast ka prezantuar nëntë masat që janë paraparë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike siç janë: 1. Lehtësimi i qasjes në financim; 2. Zvogëlimi i barrës tatimore; 3. Masat për mbështetje të punësimit; 4. Bujqësia; 5. Masat për stimulim të kërkesës agregate; 6. Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësisë strategjike; 7. Rishikimi i Buxhetit për 2020-n dhe relaksimi i kufizimeve fiskale dhe i borxhit publik; 8. Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar; 9. Mobilizimi për financimin e masave. Kryeministri Hoti iu është përgjigjur edhe shumë pyetjeve të bëra nga anëtarët e Odës Ekonomike Amerikanë që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe hapat që ka ndërmarrë qeveria në këtë drejtim.

## Mustafa premton përkrahje për sektorin e përpunimit të mishit

Prishtinë, 22 qershor (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Besian Mustafa, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Shoqatës së Përpunuesve të Mishit, Naser Rusinovci, me të cilin ka diskutuar për gjendjen e këtij sektori dhe problemet me të cilat ata po përballen. Me këtë rast, Mustafa është zotuar se do ta përkrahë këtë sektor të bujqësisë. "Do të vazhdoj të angazhohem që çdo sektor i bujqësisë ta ketë përkrahjen tonë, e sidomos sektorët të cilët janë më të ndikuar dhe të prekur nga pandemia Covid-19, ku përfshihet edhe sektori i përpunimit të mishit, në mënyrë që t'i tejkalojnë këto sfida dhe të vazhdojmë ta fuqizojmë punën e tyre edhe më tej", ka thënë Mustafa gjatë vizitave të fundit në terren, ku ka parë nga afër problemet me të cilat janë duke u përballur prodhuesit dhe përpunuesit e mishit. Ai ka theksuar se do të vazhdojë përkrahja e MBPZhR-së përmes programeve mbështetëse të subvencioneve dhe granteve.
Ndërsa kryetari i Shoqatës së Përpunuesve të Mishit, Naser Rusinovci, e ka falënderuar ministrin Mustafa për gatishmërinë dhe e ka njoftuar më hollësisht për situatën në të cilën ndodhet ky sektor.



# PDK-ja në Mitrovicë akuzon komunën për shkelje ligjore, fton prokurorinë të veprojë

**Mitrovicë, 22 qershor (ER)** - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Mitrovicë ka akuzuar Komunën e Mitrovicës për një sërë shkeljesh të pasqyrave financiare gjatë vitit 2019, të cilat janë publikuar nga Zyra Kosovare e Auditimit (ZKA).
Nënkryetari i kësaj dege, Arian Tahiri, në një konferencë për media ka potencuar 20 shkeljet e gjetura nga ZKA-ja, duke përmendur keqklasifikimin e shpenzimeve në kategori ekonomike joadekuate, parregullsi në kalkulimin e të hyrave nga tatimi në pronë, parregullsi në lëshimin e lejeve të ndërtimit, nënshkrimin e kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit etj. “Projekti ‘Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica’ në Mitrovicë, vlera e parashikuar dhe e buxhetuar për tre vjet ishte 3 milionë e 100 mijë euro, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 6 milionë e 45 mijë 726 euro, me një diferencë prej 2 milionë e 945 mijë e 726 euro. Pastaj ‘Rregullimi i shtratit të lumit Ibër’, vlera e parashikuar dhe e buxhetuar për tre vjet ishte 950 mijë euro, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë prej 1 milion e 777 mijë e 427 euro, apo 827 mijë e 427 euro më e lartë se vlera e parashikuar”, ka thënë Tahiri.
Më tutje, Tahiri i ka bërë thirrje prokurorisë së shtetit dhe organeve të tjera përgjegjëse që t’i ndërmarrin veprimet e nevojshme pasi, siç është shprehur ai, duke iu referuar raportit të ZKA-së, tashmë ekzistojnë arsyet ligjore që kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe drejtuesit e tjerë, të jenë subjekt trajtimi nga këto organe. “Të gjitha këto veprime të prezantuara në raport dëshmojnë për shkelje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Kjo dëshmon për veprat penale që janë bërë nga kryetari i komunës. Këto veprime do të duhej që kryetarin aktual ta gjenin duke u ballafaquar me drejtësinë në bankën e të akuzuarve. I bëj thirrje prokurorisë së vendit dhe organeve të tjera kompetente, që t’i ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe të menjëhershme, pasi tashmë ekziston arsyeja ligjore, duke iu referuar raportit të auditorit, që kryetari i komunës dhe drejtuesit e tjerë të jenë subjekt trajtimi për hetuesinë”, është shprehur Tahiri.




# Inspektorati në Malishevë: Nuk lejohet organizimi i dasmave në lokale hoteliere

**Malishevë, 22 qershor (ER)** - “Organizmi i dasmave dhe ahengjeve të tjera në lokalet hoteliere ende nuk është i lejuar, prandaj u bëhet thirrje publike lokaleve hoteliere, që të mos lejojnë organizimin e dasmave apo ahengjeve në lokalet e tyre”. Këtë thirrje pronarëve të lokaleve hoteliere ua ka bërë Inspektorati Komunal në Malishevë, duke kërkuar nga pronarët e këtyre lokaleve që t’i respektojnë vendimet dhe rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për shëndetësi.
Për këtë problematikë, drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit në Malishevë, Dibran Kastrati, edhe një herë ka sqaruar opinionin e gjerë dhe pronarët e lokaleve, se organizimi i dasmave dhe ahengjeve nuk lejohet pasi institucionet përgjegjëse shëndetësore i kanë ndaluar me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe kjo është një prej masave për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. “Ne si inspektorat jemi të detyruar të veprojmë për zbatimin e këtyre masave, prandaj të bëjmë edhe pak durim për tejkalimin e kësaj situate pandemike me virusin korona dhe të mos bëhemi shkaktarë të përhapjes eventuale të virusit. Në komunën tonë ka kohë që është një situatë stabile dhe nuk kemi raste aktive me Covid-19. Kjo është meritë e përbashkët e qytetarëve dhe institucioneve që janë të angazhuar për menaxhimin e situatës me Covid-19 si dhe për parandalimin e përhapjes së virusit dhe për këtë ne duhet të tregojmë ende kujdes”, ka thënë drejtori Kastrati, duke shtuar se gjatë kësaj fundjave ka pasur raste të tentimit të organizimit të dasmave dhe ahengjeve të tjera. “Për këtë qëllim, së bashku edhe me Policinë e Kosovës, jemi detyruar të ndërhyjmë në ndërprerjen e tyre. Edhe një herë u bëjmë thirrje pronarëve të lokaleve hoteliere, por edhe qytetarëve, që të vazhdohet zbatimi në përpikëri i masave dhe vendimeve qeveritare me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së qytetarëve”, ka bërë thirrje drejtori Kastrati.



# Ahmeti prezanton punën e komunës para qytetarëve lipjanas




**Lipjan, 22 qershor (ER)** - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka mbajtur një takim me qytetarë, i cili ka pasur karakter informues dhe bashkëbisedues me qytetarët lipjanas. I pari i Lipjanit para qytetarëve ka prezantuar punët të cilat janë duke u bërë në teren, në të njëjtën kohë i ka ftuar qytetarët të jenë sa më bashkëpunues me autoritetet e komunës për një punë më të mirë dhe efikase. Po ashtu, kryetari Ahmeti i ka njoftuar të pranishmit edhe për masat që ka ndërmarrë Komuna e Lipjanit për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Ndërsa qytetarët në këtë takim kanë shprehur falënderime për kryetarin Ahmeti, për punët e kryera si dhe për ndihmën dhe mbështetjen në forma të ndryshme që ua ka ofruar komuna qytetarëve për tejkalimin e situatës të krijuar nga virusi Covid-19. Në të njëjtën kohë ata kanë paraqitur kërkesat për investime në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më me prioritet për ta.

## Muharremaj prezanton planin zhvillimor të Suharekës për tetë vjetët e ardhshëm

**Suharekë, 22 qershor (ER)** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se ka bërë prezantimin e planit zhvillimor të kësaj komune për vitet 2020-2028. Ai ka thënë se pas prezantimit të këtij dokumenti para përfaqësueseve të ministrive të ndryshme i njëjti do të dalë në diskutim edhe para qytetarëve. “Dokumenti më i rëndësishëm strategjik - ‘Propozim Plani Zhvillimor i Komunës 2020-2028’ u prezantua sot para përfaqësuesve të ministrive përkatëse. Përmes këtij prezantimi synojmë ta marrim pëlqimin për hapjen e diskutimit dhe shqyrtimit publik me qytetarë, të cilët do të kenë mundësi t’i paraqesin të gjitha kërkesat dhe sugjerimet që do të ndikojnë në kompletim të dokumentit”, ka thënë Muharremaj.



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (13)

# Mendimi vizionar i Adem Jasharit për t'i ngritur strukturat e luftës



Bedri ISLAMI

Do të ishte shfaqja e parë madhore e njerëzve të gatshëm për luftë. Pas demonstratave të jashtëzakonshme në fundin e vitit 1989, kjo do të ishte tabloja e dytë e asaj që do të vinte në pasmarsin e vitit 1998.

Nëse Adem Jashari do të kishte pasur konceptin e ngushtë për luftën, pra nëse ai do të kishte menduar se "hajt, po ia fillojmë...", gjithë ata njerëz që kishin rrethuar malin, do të ishin një ngasje e madhe për ta bërë këtë. Një njeri i zakonshëm, i revoltuar, i gatshëm të luftojë, ndoshta do ta kishte parë të arsyeshme se "mund t'ia fillojmë". Në fund të fundit, do të kishte qenë e justifikueshme. Aq më shumë kjo do të kishte qenë e justifikueshme në çastet e dhimbjes vetjake, kur sheh se gjithë anëtarët e familjes janë peng i pushtuesit, kur burrat janë lidhur dhe nuk dihet fati i tyre. Por, kjo do të ishte e natyrshme për një njeri të zakonshëm, jo për njerëz që kthejnë për së mbari historinë dhe jetën e një kombi.

Adem Jashari ishte në këto të fundit, ai që atëherë do të hynte në plejadën e njerëzve që jo vetëm janë pjesë e historisë, por edhe e bëjnë atë. Dhe e bëjnë për së mbari. Ai nuk do të ngutej. E kishte të qartë se asgjë nuk do të vinte për së mbari nga grykat e Velanisë, por as nuk i bëhej merak për këtë. Po të ishte puna që të pyeteshin "institucionet" e Kosovës, as për njëqind vjet nuk do të kishte filluar qëndresa e armatosur, për të shkuar drejt luftës së pashmangshme.

30 dhjetori i vitit 1991 do të ishte fillesa e pagëzimit të parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse do të kishim pasur ngutje, nëse njeriu mit do të kishte menduar se "hajt, po ia fillojmë" do të kishte qenë lehtësisht e mundshme që çdo gjë do të ishte shkatërruar e rrënuar, ani pse njeriu që do të kishte filluar do të kishte mbetur në histori.

Adem Jashari nuk ishte nga ata burra që donte ta fillonte dhe të mbeste në histori. Ai donte të bënte një ngrehinë të tillë që, jo vetëm ta fillonte, por edhe ta përfundonte, dhe kjo nuk mund të bëhej ndryshe, veçse e strukturuar mirë, jashtë dhimbjes vetjake. Ai kërkonte të hidhej themeli i fuqishëm, i palagështitur dhe dhimbja vetjake sigurisht që do ta bënte të lagësht.

Në vitin 1993, në një fjalim publik, me rastin e varrosjes së dy dëshmorëve, Ukshin Hoti, vizionar dhe njëkohësisht dinjitoz si ai, do të thoshte krejt hapur se "Kosovës i duhet ushtria e saj çlirimtare". Do të ishte e njëjta gjë që do të sendërtonte Adem Jashari, pasi e kishte kërkuar atë, pasi kishte punuar për ta pasur atë. Mendimi vizionar, i thënë krejt shkurt nga Adem Jashari, po ashtu krejt saktë se "armët nuk i kam marrë për t'ia dorëzuar Serbisë, por që ta bëj luftën kundër saj", është krejt i njëjtë me përqasjen filozofike të Ukshin Hotit, për domosdoshmërinë e krijimit në Kosovë të ushtrisë së saj çlirimtare.

A do të kishte qenë e mundur që të kishte ndodhur krejt ndryshe, pra të kishte një fillesë lufte dhe, më pas, nuk do të dihej se çfarë do të kishte ndodhur? Është e sigurt se nëse do të kishte pasur ngritje të shpejtuar, humbjet do të kishin qenë të rënda dhe, ndoshta, të parikthyeshme. Në fundin e vitit 1991 Kosova nuk ishte e përgatitur për luftën që do të vinte. Ajo sapo kishte dalë nga protestat masive të një viti më parë, në të cilat kishte pasur edhe humbjet e ndjeshme të Afrim Zhitisë, Fahri Fazlisë dhe të tjerëve. Nëse demonstratat e atyre ditëve kishin qenë sinjali i parë i luftës që po afrohej, dhjetori i vitit 1991 ishte guri i parë i provës, provë përmes së cilës mund të kalonin vetëm ata që do të ishin të gatshëm për aktin suprem të flijimit të madh.

Mendimi vizionar i Adem Jasharit për t'i ngritur në radhë të parë strukturat e luftës, mbështetur jo vetëm te një njeri, te një familje apo te një fis, dëshmoi se kishte qenë i drejtë dhe i saktë. Fakti se rreth tij u mblodhën, në një mënyrë ose në një tjetër, nga larg ose nga afër, të gjithë ata që do të ishin njëkohësisht pjesë dhe realizues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të çon pashmangshëm te mendimi tjetër: cilët ishin ata te të cilët Adem Jashari kishte falur besimin e tij të madh dhe kishte rrokur besën se do t'u shkonin punëve deri në fund.

Është lehtësisht e dallueshme se kushdo që ka ecur nëpër rrugëtimin e luftës, në një mënyrë ose në një tjetër, ka pasur lidhje ose ka qenë i përfshirë në strukturat që lidheshin me Adem Jasharin. Nuk ka asnjë dekret të posaçëm për të, edhe po të ishte kërkuar të dilte një dekret i tillë, Adem Jashari do ta hidhte poshtë. Edhe kur bëhet mbledhja e njohur e 5 prillit 1993 në Kullën e Jasharëve, ai nuk e vendos veten mbi të tjerët, sepse as që e ka ndërmend një gjë të tillë. Fjalëpakë si gjithnjë, atë e brenin rishtas dy halle të mëdha: ecuria e ushtrisë që po ngrihet, emërtimi i saj dhe, më e rëndësishmja, ai rikthehet te mendimi tij për përgjegjësinë e aksioneve. Mbledhja e 5 prillit në Prekaz është një ndër më të rëndësishmet për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Disa nga emrat e njohur të luftës do të jenë pjesë e saj, mes të cilëve edhe Fadil Kodra, Hamit Jashari, Sahit Jashari, Besim Rama, Rafet Rama, Hashim Thaçi, Jakup Nura, Ilmi Zeka, Jakup Krasniqi, Sami Lushtaku e të tjerë. Fakti që mblidheshin në kullat e Jasharëve, megjithëse ajo ndodhej nën vëzhgimin e përhershëm dhe mund të sulmoheshin, dëshmon për dy gjëra: sigurinë që afronte ajo dhe rolin prijatar të Adem Jasharit.

Megjithatë, ai kurrë nuk e ka kërkuar një gjë të tillë, por e gjithë kjo, brenda Kosovës, u bë krejt natyrshëm, si diçka e zakonshme dhe e kuptueshme. Nëpër portat e atyre kullave do të hynin Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi, Sulejman Selimi, Nait Hasani, Ramiz Lladrovci, Jakup Krasniqi, Iliaz Kodra, Nuredin Lushtaku, Abedin Rexha, Kadri Veseli... më parë e kishin bërë këtë rrugë Ahmet Haxhia dhe Ramadan Avdiu, më pas do të shkonin drejt saj Adrian Krasniqi dhe Daut Haradinaj, do të kishin lidhje me të Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Fehmi Lladrovci, kjo do të thotë se do të gjesh thuajse të gjithë emrat e njohur të luftës.

Kjo nuk ka qenë rastësi dhe nuk do të ishte, po ashtu e rastësishme, që në ditët më të vështira, do ta kishin të domosdoshme mbështetjen tek emri i Adem Jasharit. Krejtësisht logjikshëm ai u bë qendra e luftës dhe rrjedhja e mëpasshme e ngjarjeve dëshmoi vërtetësinë e thënies së Shaban Jasharit, se "besën po jua jap, nëse kërcet në Prekaz, ka me kërcitë në të gjithë Kosovën".

Sidoqoftë, unë do të doja t'i sjell tre shembuj, krejt shkurt.

- është i njohur fakti se Zahir Pajaziti, po ashtu një emër i njohur i luftës, ndoshta nga të paktit drejtues të strukturave të saj që nuk ishte takuar personalisht me Adem Jasharin, në natën e 31 janarit 1997, kur edhe do të vritej, kishte njërin ndër synimet e tij, takimin me Jasharët;
- në fillimin e marsit 1998 do të ndodheshin në Prekaz edhe dy nga figurat emblematike të luftës, Rrustem Mustafa dhe Rrahman Rama. Megjithëse vinin nga dy zona të ndryshme, ata kishin prirë drejt Prekazit për të njëjtin qëllim: të takoheshin me Adem Jasharin dhe ta merrnin mendimin e tij nëse kishte ardhur koha t'ia fillonin luftës;
- në të njëjtën kohë, pra krejt në fillimin e marsit 1998, dy drenicas, njëri nga të cilët do të dëshmonte më pas se ishte i denjë të hynte në historinë e kombit si një ndër heronjtë e mëdhenj të tij, Fehmi Lladrovci dhe Sami Lushtaku, kishin braktisur Gjermaninë dhe po ktheheshin përfundimisht në Drenicë. Gjithë rrugës, kur ende nuk e kishin marrë lajmin për vrasjen e Jasharëve, ata kishin vetëm një brengë: çfarë do t'u thoshte Adem Jashari, çfarë do t'i thoshin ata, si do t'i priste ai...

Sepse kjo ishte forca e këtij njeriu. Kalimi përmes miqësisë së tij ka qenë, si të thuash, pa dashje, një gur prove, një moment i rëndësishëm i jetës prej luftëtari.

Adem Jashari i kthehej gjithnjë mendimit të vet vizionar se duheshin ndryshuar rrjedhat e qëndresës dhe se këtë nuk mund ta bënte vetëm një njeri, cilido qoftë ai. Ai në mënyrë të pashmangshme ishte ndër vizionarët që, jo vetëm e kuptoi, por edhe e sendërtoi faktin se lufta nuk ishte pragu i shtëpisë, nuk ishte caku i fundit i oborrit, sinori i fshatit apo mali përballë. Lufta ishte më e gjerë se kaq dhe për motive shumë më thelbësore, për të cilat ia vleje të luftoje dhe të sakrifikoheshe.

Adem Jashari bëri më tej në këtë rrugë.

Njëkohësisht ai po shkruante edhe vizionin e ri të kohës që po vinte dhe këtë nuk po e bënte me fjalë të mëdha, por krejt natyrshëm, duke kaluar përmes gjërave të shenjta për të. **(Vijon)**



# Opinioni i Komisionit të Venecias për Shqipërinë: Zgjedhjet, kushtetuesja, media



Prof. Lisen BASHKURTI

Shqipëria po përjeton një krizë të thellë dhe komplekse. Tanimë kjo krizë është konstatuar qartësisht nga organizatat kryesore evropiane të cilat merren me Shqipërinë. Organizatat evropiane janë enë kapilare të lidhura ngushtësisht nga vlera, parime, norma dhe institucione. Ato kanë në themel demokracinë parlamentare, pluralizmin politik, shtetin e së drejtës me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, ekonominë e tregut të lirë.

Kohët e fundit, tërësia e organizatave evropiane, duke përfshirë, OSBE/ODIHR, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës si dhe Parlamenti i Bashkimit Evropian kanë vënë Shqipërinë në fokus kritik në akord kapilar evropian. Kritikat janë bërë në formë të drejtpërdrejtë, në formë opinionesh apo në formë rekomandimesh. Por, pavarësisht prej formës së bërë, në thelbin e tyre, kritikat, opinionet apo rekomandimet shprehin qartë problematikën thelbësore serioze të Shqipërisë, me të cilën ajo duhet të përballet për realizimin e aspiratës mbarë shqiptare për ta bërë Shqipërinë anëtare të Bashkimit Evropian.

## 1. Komisioni i Venecias për zgjedhjet e 30 qershorit dhe Gjykatën Kushtetuese

Komisioni i Venecias është i njohur ndryshe 'Komisioni Evropian, demokracia përmes ligjit' është një trupë këshillimore e Këshillit të Evropës, e përbërë nga ekspertë të pavarur në fushën e të drejtës kushtetuese. Kjo trupë është themeluar në vitin 1990, pas rënies së Murit të Berlinit, për të asistuar në të drejtën kushtetuese në Evropën Qendrore dhe Lindore. Nga vendndodhja e tij, njihet si Komisioni i Venecias. Detyra kryesore e Komisionit të Venecias është asistojë dhe këshillojë vendet individuale me qëllim që ta përmirësojnë funksionimin e institucioneve demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Detyrë tjetër e Komisionit të Venecias është edhe në fushën e zgjedhjeve, referendumeve dhe partive politike, drejtuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike, i cili përbëhet nga përfaqësues të Komisionit si dhe nga Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Dhe, së fundi, një degë tjetër e aktiviteteve të Komisionit të Venecias lidhet me gjykatat kushtetuese dhe trupat gjyqësore ekuivalente të tyre.

Shqipëria është një nga vendet që më së shumti është asistuar dhe këshilluar nga Komisioni i Venecias në të gjitha fushat e mësipërme. Nga viti 2019 Komisionit të Venecias i është kërkuar opinion këshillimor nga Shqipëria lidhur me dekretet e presidentit Meta për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019; për procedurën parlamentare për shkarkimin e presidentit Meta; për zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese; si dhe për Ligjin Anti-Shpifje për median online.

Lidhur me dy kërkesat e para, zgjedhjet e 30 qershorit 2019 dhe Gjykatën Kushtetuese, Komisioni dha opinionin e paraprak në shtator 2019 si dhe opinion përfundimtar për të gjitha çështjet në qershor 2020. Siç vërehet nga analistë të shumtë vendës dhe ndërkombëtarë, si asnjëherë tjetër, opinioni përfundimtar i Komisionit të Venecias për Shqipërinë në qershor 2020 pësoi ndryshime thelbësore krahasuar me projektin e tij paraprak i shtatorit 2019.

Lidhur me zgjedhjet e 30 qershorit 2019, thelbi i ndryshimit qëndron në vlerësimin e Komisionit të Venecias, sipas të cilit, presidenti i Republikës, Meta, nuk ka shkelur Kushtetutën dhe nuk ka tejkaluar kompetencat e veta kushtetuese. Me veprimet, qëndrimet dhe deklarimet e tij, presidenti i Republikës, Meta, pati qëllim legjitim, që synonte shmangien e gjakderdhjes, mbrojtjen e pluralizmit politik, ruajtjen e stabilitetit dhe reputacionin demokratik të vendit. Presidenti Meta ka respektuar frymën dhe germat e Kushtetutës sepse kompetencat kushtetuese të presidentit nuk janë formale. Nga ana tjetër, dekretet e presidentit janë në fuqi dhe nuk u sfiduan përpara asnjë gjykate. Gjithashtu, duhet vënë në dukje fakti juridik se zgjedhjet parlamentare kanë status më të lartë kushtetues se zgjedhjet vendore.

Në reagimin e presidentit Meta rreth draftit paraprak të Komisionit të Venecias lidhur me gjykimin e dekreteve të tij për zgjedhjet e 30 qershorit 2019, ai argumentoi se "vetëm Gjykata Kushtetuese mund t'i gjykojë dekretet e presidentit me natyrë kushtetuese". Kjo deklaratë e presidentit Meta është miratuar nga Komisioni i Venecias në opinionin përfundimtar, i cili në thekson në pikën (99) "do të jetë Kuvendi dhe në përfundim Gjykata Kushtetuese që do të vendosë nëse anulimi dhe më nëse shtyrja e zgjedhjet vendore paraqet një shkelje të Kushtetutës…"

Për konsekuencë, Komisioni i Venecias saktëson qëndrimin e tij lidhur me vendimin e mazhorancës parlamentare për hapjen e procedurës për shkarkimin e presidentit Meta. Komisioni në pikën (99) të opinionit përfundimtar qartëson se do të jetë sërish Kuvendi dhe në përfundim Gjykata Kushtetuese që do të vendosë edhe… "nëse shkelja është me karakter serioz, e cila do ta lejonte shkarkimin e Presidentit. Për më tepër, Komisioni i Venecias dyshon se edhe nëse veprimet e presidentit mund të konsiderohen në shkelje të Kushtetutës, a mund të quhen ato serioze mjaftueshëm për ta kërkuar shkarkimin".

Në mënyrë eksplicite Komisioni, shprehet lidhur me veprimet, qëndrimet dhe vendimet e presidentit Meta, në pikën (101), ku thekson se… "duke i bërë bashkë këto veprime ato nuk përmbushin kriterin e kërkuar për krijimin e rrethanave për një kërkesë kaq serioze sa shkarkimi i presidentit".

Në lidhje me opinionin përfundimtar për Gjykatën Kushtetuese dhe procedurën e zgjedhjes dhe betimit të anëtarëve të saj, Komisioni i Venecias ka dhënë opinion të qartë, pa ekuivokë, sipas të cilit, ka pasur shkelje procedurale serioze nga mazhoranca për të kapur këtë organ të lartë të gjyqësorit, me anë të heqjes së të drejtave të presidentit për emërimin anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese si për dhe betimin e anëtarëve të kësaj gjykate përpara tij, mbi parimet "check and balance" dhe të pavarësisë së pushteteve.

Një shkelje e tillë e mazhorancës ka bërë që vendi të rrijë për një kohë të gjatë pa Gjykatë Kushtetuese, çka ka krijuar një vakuum i cili është abuzuar nga mazhoranca dhe qeveria për të ndërmarrë akte ligjore dhe vendime ekzekutive antikushtetuese, duke penguar seriozisht rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.

Me opinionin përfundimtar, Komisioni i Venecias e faktoi pa ekuivokë synimin e mazhorancës dhe qeverisë për të kapur çdo organ të sistemit të drejtësisë, duke devijuar nga parimet dhe procedurat e reformës kushtetuese për drejtësinë të vitit 2016. Synimi i mazhorancës dhe qeverisë ka qenë për t'i rrëmbyer presidentit të drejtën kushtetuese për emërimin e anëtarëve në Gjykatën Kushtetuese, përmes KED dhe drejtuesit të tij. Gjithashtu, mënjanimi antikushtetues i presidentit për Gjykatën Kushtetuese është synuar edhe me anë të devijimit të procedurave të betimit të anëtarëve të kësaj gjykate, nga një akt e detyrueshëm dhe solemn përpara presidentit, tek një akt noterial dhe i rëndomtë përmes një vendimi të veçantë të mazhorancës.

Presidenti Meta, padyshim, ka meritën historike qëndroi në mbrojtje të Kushtetutës dhe nuk iu nënshtrua presionit të mazhorancës dhe qeverisë për kapjen e Gjykatës Kushtetuese. Është hera e parë, që nga viti 2018, që një organizatë ndërkombëtare sulmon reformën në drejtësi, identifikon, akuzon mosfunksionimin e shtetit kushtetues në Shqipëri, duke vërejtur shkelje të rënda të Kushtetutës.

Këto konstatime të Komisionit të Venecias janë kritika që bien njëkohësisht mbi mazhorancën, qeverinë shqiptare, por edhe mbi përfaqësitë e USA dhe BE në Tiranë së bashku me misionet e tyre OPTAD dhe EURALIUS që janë asistues dhe në një farë mënyre edhe garantues për zbatimin e drejtë të reformës në drejtësi në Shqipëri.

## 2. Komisioni i Venecias për Ligjin e medias online

Në opinionet e kohëve të fundit të Komisionit të Venecias për Shqipërinë është lidhur me Ligjin Anti-Shpifje për Median, të mazhorancës në Shqipëri. Paraprakisht, presidenti Meta nuk e dekretoi këtë ligj, duke e konsideruar si një shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për shprehjen e mendimit të lirë.

Paketa ligjore 'Anti-shpifje' ose e thënë më qartë e censurës për median online është bërë objekt i fortë i debatit politik, publik dhe mediatik në vend. Për pasojë rishikimi i këtij ligji, që qeveria duhet të plotësojë, është renditur një nga kërkesat themelore për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në. Mazhoranca në pushtet nuk ka vepruar në përputhje me standardet evropiane. Qeveria deri tani është përpjekur ta miratojë planin për ta adoptuar Ligjin e censurës, duke e shndërruar institucionin e AMA (Autoritetin e Medias Audiovizive dhe Këshillin Mbikëqyrës të Radio Televizionit Shqiptar), në trupa partiake për kontrollin e medias online, me anë të politikave të emërimeve.

Loja e qeverisë deri kohët e fundit është e dyfishtë, nga njëra anë bën sikur është e kënaqur me vendimin e Komisionit të Venecias, që rrëzoi Ligjin e tij të censurës, nga ana tjetër vazhdon të insistojë të mbajë në një garë politike vartësit e saj për kreun e AMA-s. Në Ligjin e censurës së medias, AMA është institucioni që vendos mbylljen e një portali online, posaçërisht në rastet e denoncimit të aferat korruptive të qeverisë, anëtarëve dhe drejtuesve të saj.

Lidhur me këtë ligj Komisioni i Venecias foli qartë kundër paketës së qeverisë për median. Komisioni theksoi tri parime themelore: së pari, paketa 'anti-shpifje' rrezikon hapur lirinë e medias dhe të shprehjes; së dyti, paketa 'anti-shpifje' nuk duhet të kalojë me ndryshimet e bëra nga qeveria'; së treti, qeveria duhet të mbështesë një mekanizëm vetërregullator me pjesëmarrjen e të gjitha palëve. Më tej Komisioni shprehet se "fuqitë e reja nuk duhet t'u jepen AMA-s dhe AKEP-it, pa siguruar më parë se ato janë mjaftueshëm të pavarur nga partitë politike, nga bizneset e mëdha të medias dhe nga interesat e korporatave të lidhura me politikën".

Në kushtet e demokracive hibride, ku bën pjesë edhe rasti i Shqipërisë, media online mbetet burimi kryesor i informimit të publikut shqiptar, burimi më i besueshëm i transparencës si dhe media më investigative për aferat korruptive e kriminale të qeverisjes në vend.

Opinioni i Komisionit të Venecias kundër Ligjit të censurës është qartësisht në frymën e qëndrimit të presidentit Meta në arsyetimin ligjor për mosdekretimin e tij. Duke analizuar opinionin përfundimtar të Komisionit të Venecias, presidenti Meta deklaroi se "shpreh keqardhjen që gjatë katër muajve u shpërdoruan energji, që do të duhet të ishin në shërbim të integrimit evropian të Shqipërisë dhe vendimit të shumëpritur për çeljen e negociatave të anëtarësimit në BE".

# EDHE NJË SUKSES TJETËR I SHKRIMTARES BASRIE MURATI-SAKIRI



Lulëzim ETEMAJ

Përgjatë kohës së pandemisë COVID-19, me qëllim për ta mbajtur gjallë në rrethana të jashtëzakonshme kulturën e leximit, Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag", një nga më të njohurat në Zvicër, ka mbajtur dhe publikuar në "Facebook" dhe "Instagram" "DitarinKatërdhjetëDitorë-Të jetosh dhe të lexosh në gjendje të jashtëzakonshme" ("VierzigTageBuch-Leben und Lesen im Ausnahmezustand"), shkruar çdo ditë nga një prej autorëve të saj (https://vierzigtagebuch.wixsite.com/rotpunktverlag).

Në mesin e dyzet autorëve, ajo e ka përfshirë edhe shqiptaren nga Kosova, Basrie Murati- Sakiri. Tregimi i saj "Ein Tag, der keinem anderen gleicht" ("Një ditë që s'i ngjanë asnjë tjetre"), i botuar më 7 prill 2020, është pritur me interesim të madh nga lexuesit. Për nga numri i pëlqimeve, ai është radhitur pas tregimit të Tim Shaw, "Marathon im Hinterhof" ("Maratonë në oborrin e pasmë") si më i pëlqyeri. https://vierzigtagebuch.wixsite.com/rotpunktverlag/post/basrie-sakiri-murati-ein-tag-der-keinem-anderen-gleicht

Ky është një nga sukseset e mëdha të radhës së kësaj autoreje të talentuar dhe shumë premtuese. Siç ka njoftuar këto ditë autorja përmes një postimi në "Facebook", "Rotpunktverlag" të gjitha shkrimet e ditarit të saj dyzetditor i ka shtypur si botim të veçantë dhe ua ka shpërndarë autorëve dhe përkrahësve të saj.

Basrie Murati-Sakiri emigron si 18-vjeçare nga Kosova në Zvicër. Shkaktar ishin aktivitetet politike, të cilat ia pamundësuan jetesën e mëtejme në Kosovë. Ishte pjesëtare e "Çetës së Llapit". Ajo ka shkruar për dhe rreth këtij historiku të veprimtarisë atdhetare.

Lexuesit e interesuar në Zvicër, Gjermani dhe Austri, librin "Bleibende Spuren" mund ta porosisin te "Rotpunktverlag": https://rotpunktverlag.ch/buecher/bleibende-spuren

Shkrimtarja është, po ashtu, edhe autore e librit në gjuhën shqipe "Gjurmë të pashlyeshme", i botuar në Prishtinë, i cili mund të porositet në Librarinë Shqiptare duke klikuar në këtë link: https://www.librariashqiptare.ch/product-page/gjurmë-të-pashlyeshme











E rrallë

## Kina befason botën, treni me shpejtësi 600 km/h realizon udhëtimin e parë



Një tren gjigant që arrin shpejtësinë maksimale prej 600 km/h kreu me sukses udhëtimin e parë testues në një hekurudhë në Shangai të dielën. Zhvillimi i një sistemi transporti hekurudhor me shpejtësi të lartë është një prej prioriteteve të Kinës.

## BARSOLETA E DITËS



**- I thirra këta për rrymë, u thashë çka u bo kështu më ka ardhur fatura 75 euro këtë muaj?**
**- Thanë ju kërkojmë falje, kemi bo gabim, se 92 euro të paska ardhur.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

FOTO E DITES




Kryeministri britanik Boris Johnsoni shihet duke pritur në radhë për të pastruar duart për shkak të virusit Covid-19.



# Ermal Mamaqi publikon bisedën private me Elvana Gjatën

Elvana Gjata dhe Ermal Mamaqi, prej vitesh ruajnë një miqësi shumë të ngushtë dhe shpesh herë e quajnë njëri-tjetrin motër e vëlla.
Së fundmi në një video që Ermali ka publikuar me Joelin dhe një qen, Elvana e ka "bullizuar" aktorin duke i dërguar një mesazh në "Instagram".

*Sa i mirë o Zot! Joeli si Ami, qeni si ty!"*

Ermali ka publikuar bisedën e tyre dhe krahas saj shkruan: "SKANDAL!!! ZBULOHET BISEDA…Ja pra miq… Ja bullizmi i @elvanagjataaaa në mesazhet private."
E gjithë biseda ka qenë me shaka duke shkaktuar të qeshura tek ndjekësit.




E jashtëzakonshme

## Një rezidencë e stilit francez mund të blihet për vetëm 1 funte në Skoci



Një rezidencë e stilit francez pritet të vendoset në ankand me një çmim fillestar prej një funte, por blerësit e mundshëm po paralajmërohen të hedhin një sy brenda së pari. Sipas mediave të huaja, prona në Arbroath, Angus në Skoci, është ndërtuar në shekullin e 19-të dhe ka shumë nevojë për intervenime.



**DASHI**
Do t'ju ndodhë një problem i madh në punë, për të njëjtën arsye, si gjithmonë, do të bëni gabime.



**DEMI**
Gjërat do të ecin më së miri, do t'ju vijnë mundësi të arta nga njerëz me pushtet. Në frontin sentimental dashuria do të jetë e fortë.



**BINJAKËT**
Mund t'ju vijnë mundësitë e duhura për t'i nxjerrë aftësitë dhe cilësitë tuaja që nuk po i përdorni aktualisht.



**GAFORRJA**
Mundësi të shkëlqyera në frontin profesional. Do të krijoni diçka që do të zgjasë gjatë, kursimet do të rriten falë të ardhurave dhe aftësitë tuaja për t'i menaxhuar ato do të përmirësohen.



**LUANI**
Padyshim se nuk është faji juaj që ndodhin gjëra të papritura, por fakti se planet tuaja janë prishur nuk do t'ju pëlqejë aspak.



**VIRGJËRESHA**
Ju jeni në harmoni të përsosur me botën përreth jush dhe kjo mund të ndikojë vetëm pozitivisht në gjendjen shpirtërore dhe buzëqeshjen tuaj.



**PESHORJA**
Shmangni blerjet, nuk jeni në gjendje të bëni blerje interesante, e lëre më me një çmim të mirë.



**AKREPI**
Yjet sot inkurajojnë kontaktin me njerëzit e tjerë dhe ju bëjnë mjaft popullorë. Të pajisur me një magnetizëm të fortë personal do të keni një imagjinatë.



**SHIGJETARI**
Saktësia dhe programimi janë kartat më të mira të ditës. Ndihesh kurioz, intuitiv dhe i mençur.



**BRICJAPI**
Kryerja e angazhimeve të ndryshme nuk është e lehtë, madje as të bisedosh në mënyrë paqësore me njerëz të afërt.



**UJORI**
Shfrytëzoni situatën për të rregulluar më mirë atë që nuk funksionon si në punë, po ashtu edhe në jetën private.



**PESHQIT**
Do të jetë e lehtë për ju që të arrini pozicione prestigjioze, ta vendosni veten në vend të parë, ta rirregulloni punën tuaj, të përballeni dhe të zgjidhni edhe çështje të vështira.

# Johnny Depp i rikthehet Jack Sparrowit për t'i argëtuar fëmijët në një spital



Aktori hollivudian Johnny Depp i është rikthyer edhe një herë rolit të tij si kapiteni i famshëm Jack Sparrow për t'i argëtuar fëmijët e një spitali në Queensland. 57-vjeçari pati një takim virtual me të gjithë fëmijët e sëmurë të cilët nuk i takonte dot personalisht për shkak të pandemisë së Koronavirusit. "Kam gati dy vjet që nuk kam ardhur aty dhe më ka marrë malli shumë. Vendosa t'ju përshëndes në këtë mënyrë", ka thënë ai në video duke i emocionuar të gjithë.

# Kitara e liderit të 'Nirvana', Kurt Cobain, shitet në ankand për 6 milionë dollarë



Disa dekada pasi Kurt Cobein u vetëvra, kitara me të cilën ai performoi gjatë performancës së tij legjendare MTV unplugged më 1993 është shitur me një çmim të pritshëm prej 6 milionë dollarësh. Kitara akustike-elektrike Martin D 18E që Cobain përdori për performancën e famshme në Nju Jork, vetëm pesë muaj para se ta vriste veten në moshën 27-vjeçare është blerë nga sipërmarrësi australian Peter Freedman, themelues i kompanisë "Rde Microfones".



# Habit Leonardo Dicaprio, mezi mban pantallonat në 23-vjetorin e të dashurës

Leonardo Di Caprio ka përgatitur një surprizë të veçantë për të dashurën e tij, Camila. Që tri vjet çifti është në një lidhje dhe duket më i lumtur se kurrë. DiCaprio, 45 vjeç dhe Camila Morrone u bashkuan me miqtë për ta festuar ditëlindjen e 23-të të saj me një festë të çmendur në një jaht luksozë. Ylli i Titanicut dhe e dashura e tij, 23 vjeçe, kishin kombinuar veshjet. Ata u panë me kapelë të madhe në kokë teksa po mbërrinin për festë, festimet kishin filluar në orën 11:00 të paradites. Aktorja e "The Death Wish" thuhet se ka shijuar muajt e fundit të izolimit në shtëpinë e Leos në Hollywood.

# Dy femra akuzojnë për përdhunim Justin Bieberin, ja çfarë iu tha këngëtari



Dy femra e kanë akuzuar këngëtarin Justin Bieber për përdhunim, të cilat kanë shpërndarë përvojat e tyre në rrjete sociale. Në fundjavën që lamë pas, një vajzë e identifikuar si Danielle ka treguar përmes rrjetit social "Twitter" në detaje se si ata janë takuar në një event në vitin 2014, shkruan "Vulture". "Unë dhe shoqëria ime ishim duke shijuar gjithë natën. Një mashkull u afrua pranë nesh dhe na pyeti nëse donim ta takonim Justin. Sigurisht që thashë po", u shpreh ajo. Sipas saj, Bieberi ishte kënaqur pak me shoqërinë e tij, më pas u ftoi të gjithë që të shkonin në dhomën e një hoteli.




LETËR E AUTORIT ONUR CAYMAZ, DREJTUAR BOTUESIT TË TIJ XHEVAIR LLESHI (UEGEN):

# Onur Caymaz: Të gjithë lexuesit e mi shqiptarë i kam kushërinj të largët

*Si fëmijë, në shtëpi, veç turqishtes, herë pas here, gjyshja dhe nëndaja ime flisnin edhe një gjuhë tjetër. Ndonjë fshehtësi, thashetheme ose gjëra që me gjasë unë s'duhej t'i dëgjoja…Çuditesha, mundohesha të kuptoja. Tani asnjëra prej tyre nuk është gjallë. Çuditesha shumë! Midis fjalëve të tyre zgjateshin përtej pjergulla rrushi, piqeshin petulla, pastaj përgatitej kos me hudhra: Shqipja… Gjuha e vendit ku qenë lëruar rrënjët e mia, toka ime.*
*Kthesat e bukura të shqipes, pjerrinat e mrekullueshme, vajzat e bukura faqekuqe, burrat e pashëm me duar gigante, i pata ndjerë përsëri, shumë më vonë, në Durrës, me rastin e festivalit poetik Festivali Poeteka, të organizuar nga Arian Leka, me miqtë poetë në Berat, ose në një bar në Tiranë me Albana Kozeli, përkthyesen e poezive të mia, dhe gjithë duke e shtrydhur fort kujtesën, e pata vënë re, se në fakt e kuptoja pak a shumë këtë gjuhë të lashtë të Evropës, madje edhe mund ta flisja qoftë edhe një grimë.*
*Kur iu vura kërkimit të origjinës, pemës familjare, e kuptova se jo vetëm im atë, por edhe ime më kishte prejardhje nga Shqiperia, nga Leksoviku. Edhe poetët më të mëdhenj të turqishtes time kanë qenë bashkëvendasit e mi: Memet Akif Ersoji, i cili shkroi marshin e pavarësisë dhe Shemsedin Samiu, autori i romanit të parë turk.*
*Kurse kjo është një gjë krejt e re: Arbana Rexhepi e njoha para një viti, falë një e-maili që ajo më dërgoi. Më shkruante se sa shumë i pëlqente shkrimet e mia. Sa mirë që e fliste turqishten. E këtillë është jeta, e çuditshme, me kësolloj pikëtakimesh të çuditshme. Më pas, Arbana përktheu një tregim timin që u botua në revistën letrare illz – Revistë letrare e Tiranës. "Po sikur të përpilojmë një libër", tha, kur i erdhi dita: " E gjej unë shtëpinë botuese"…Një pikëtakim tjetër: Xhevair Lleshi dhe familja e Uegen Shtepia Botuese. E si mund ta harroj shkrimin tërë mirësjellje që zotëri Xhevahiri shkroi në fund të librit. Tanimë zëri im tjetër, mbetur nga shumë larg, nga paraardhësit e mi, takohet me lexuesit e mi shqiptarë, pra, me kushërinjtë e mi të rinj të largët. Të gjithë lexuesit e mi i kam kushërinjë të largët; kurse të shkruash është ta sfidosh vdekjen. Atëhetë, le t'i mbjellim farat edhe një herë, në një gjuhë tjetër; bashkë, të gjithë së bashku. E di, shpirtërat tanë paskëshin qenë të pavdekshëm…Tregimet e mia janë tani me ty, përshëndetje, shqipja ime e bukur. Me gotën në dorë, përshëndetje! Gëzuar!*

*8 qershor 2020*

## TREGIME SI FLIRTE TË PABESUESHME

**Nga Xhevair LLESHI**

Onur Caymaz, shkrimtar i ri turk me origjinë shqiptare. Një libër me tregime: «Dashuria, asgjë…»Përkthyer nga e talentuara Arbana Rexhepi (Shkup).




Një libër që rrjedh ëndshëm. E sheh nga larg: si njolla në telajo, hije, por gjithçka galduese. Ende dëgjon në veshë buçimë zërash, dridhje të lehta, shpërthime, gudulisje, britma, të qeshura… Në vetminë tënde vinin përqark hijet e personazheve. Mungonte vetëm mikrofoni pranë gojës dhe pastaj ato mërmërimat e zakonshme të jetës së përditshme, të rrethon një dashuri ndryshe, që pluhuron dhe bëhet… asgjë, me skenat e një filmi të harruar po edhe këta nuk mjaftojnë. Se fjala kthehet në mit. Dhe lëvizin në mënyrë jo skematike njerëz, plaçka, kollitje, mure, trupa kokallë, dhimbje të thella, bukuri që të lënë pa mend dhe përplot frymë poetike. Pse pak ju duket qoftë edhe kjo frymë, në metafora që shndrisin dhe të krijojnë gjendje të forta emocionale, njerëz të çuditshëm si në rrëfenjat e lashta që zbresin në tokë e nuk të lënë as të mbushesh mirë me frymë, ndoshta edhe të shtyjnë me forcë drejt korridoreve të tjera të fjalës së bukur e të mençur me prerje të forta e në flirte të pabesueshme. Herë-herë pranë teje dikush që frymëzon, një tjetër që jep shpirt dhe të kërkon ndihmë, të tjerë, të pashpirt sigurisht, të belbëzojnë mençuri tronditëse në çastet e fundit…
Tregimet e Onur Caymaz-it janë meditime të holla e të thella psikologjike, gjendje të forta e kapitëse. Të shoqëruara nga mendime të holla, duke ecur gjithnjë në teh të thikës, në një shprehje që të frymëzon e të krijon gjendje. Të duket se ti mbreh «kaun e arës» dhe e ndihmon atë, meqë është në gjendje të vajtueshme, për ta punuar vetë atë, nganjëherë të hysh në lëkurën e personazhit që mendon e mendon pa fund rreth ndarjes me njeriun që do, që, i divorcuar, kthehet mbrapsht dhe ecën para, këmbëngul më kot, lodhet pa fund, bërtet e s' dëgjohet askund… Njerëzit janë dhe nuk janë kudo. Të mbyt duhma e tyre e përvuajtur, një zjarr që s'të ngroh, po edhe këndellesh nga pak kur mendon se sheh diçka që të

→

shëmbëllen si zjarr. Veç kudo gëlojnë nëpër dritë po edhe në errësirë, më fort si hije nëpër mure, po prapëseprapë të mbetet të thuash se janë të lumtur që ndihen të lirë. Le të jetë ndjesi e largët. Personazhe të vërtetë e të gënjeshtërt që të afrohen e të pëshpëritin, ku edhe i merreshin vesh edhe jo mendimet, ku bëjnë atë që u thonë dhe nuk thonë kurrë atë që bëjnë, ku fryn gjithnjë briza e hollë e mendimit. Vijnë dhe ikin. Hyjnë dhe dalin. Veç gjithnjë frymojnë, i presin «drutë» shkurt…

Të gjitha tregimet kanë një frymë emocionuese e përplot art. Të mjerët njerëz, ndonëse të shoqërojnë me humor dhe tregohen të guximshëm, të nxjerrin jashtë nga binarët, zhduken e duken menjëherë, s'dinë ku ta çojnë tërë atë bukuri, zgjuarsi e mirësi, kurse herë të tjera thyejnë keq veten, tallen, shfryjnë, këndojnë, hedhin valle, ndrydhen, turpërohen, ndukin mustaqet a fërkojnë mjekrën, me një fjalë s'dinë ç'bëjnë. Ata, personazhet e Onur Caymaz-it e ndjekin plumbin, nuk harrojnë kurrë, e gjejnë të vërtetën, bashkëjetojnë me gjendjen e rëndë, janë gati të vetëvriten, po kush i beson? I beson thua ai (ajo) që tallet me ta (to)? Duket sikur diku fjalët shkurtohen, prishen gjendjet mendore, madje sikur i përmbyt shkallimi, nuk e lënë të kaluarën dhe sikur e mbajnë më pranë se s'duhet, nuk e nxjerrin dot qimen nga qulli, që shohin përpara dhe nuk lejojnë mendim tjetër të pipëtijë. Sigurisht ka prej tyre që tregohen fanatikë, ekstremistë, që s'pyesin për njeriun, as për ide, që e kanë lidhur pronën me shpirtin, që mundën e fitojnë, që të betuar për kauzën luftojnë, që e shohin veten edhe si mostër po edhe si engjëj, të humbur e të shuar, që shohin larg, dëgjojnë dhe reflektojnë gjersa vjen gjithnjë një ditë dhe kuptojnë të vërtetën e thjeshtë, se bëhen të famshëm edhe të rrethuar nga gjërat e thjeshta e të vogla, sikur rrojnë dhe nuk rrojnë, që nuk i tremben asgjëje, se e pranojnë dënimin, ndërsa të tjerë të mjerë gjer në thelb rronte me frikën e imët të dënimit përditë. E vërtetë: këta personazhe të kohës dalin nga apartamentet apo dhomat e hotelit siç dilnin dikur nga kasollet andej nga skërkat e Anadollit dhe vijnë e përplasen në Stamboll, në metropol.

Dhe përmes mendimit të tyre gërryes ti sheh gjendjen e vërtetë psikologjike edhe në përshkrimin e perëndimit e diellit apo lindjen e tij. Duket sikur nën rreshta të thonë se ndihen mirë në qendër dhe i gëzohen pijes së fshehtë në periferi. Gjithçka e thjeshtë dhe me një humor të fshehtë (por jo tallës) vjen dhe rri pranë teje në shitoret e mrekullueshme të Pazarit të Vjetër, po edhe në një hotel luksoz, aq pranë, kur dielli shkon e mbytet në det. Dhe lexuesi mbyll në dorën e ashpër atë që i mungon shumë. E ndjen se makuti është aty dhe të pëshpërit ndërsa ti ia dallon frikën. Se ti natyrisht që je më i fuqishëm, ke më shumë zemër e dashuri. Dikush prej tyre hap dorën, këqyr një grimë vajzën moderne por krejt të vetmuar, që bëjnë përshtypje, që i bie në sy halli te zbehtësia e fytyrës dhe po aq te mungesa e oreksit, te shenja për të dalë. Atje shikon diellin e madh të korrikut teksa nxjerr syrin befas nga një hapësirë përmbytur nga mjegullnaja e qumshtët apo kur humbet krejt në det. Vajza godet vetëm me shpirt dhe, befas dëgjohen thirrje histerie, këngë, valët e një furie dalldisëse, madje duket se rretheqark saj njerëzia kishin pirë me grushte eliksir dashurie. Dhe mos harroni asnjëherë: në dhomë apo kudo të jesh bredhin hijet nëpër mure dhe bëjnë zjarr të fshehtë që buron me siguri nga shpirti i dikujt.

Duket se çdo gjë në këto tregime është pagëzim pa foshnje. A e shikoni gjëkund foshnjën e lirisë së munguar? Jo, sepse kjo është një imagjinatë. Dhe kurdoherë luhet me fjalët, me fjalinë e shkurtër, me aforizmin dhe një deduksion e mbledhur grusht. Aty-aty bëhet gjak po befas kjo nuk ndodh, me një të papritur të këndshme, diku tjetër lidhet një marrëveshje e heshtur apo diç fshihet pas kulisave. Shumë më vonë renditen dhe dalin faktet, po rrugën e lirisë e sheh të sakatuar dhe të vështirë. Dhe ta besosh që njerëzit ia kanë mbushur mendjen vetes se ndihen të lirë. Ka plot situata rrëqethëse, aq sa të duket se ke aq pranë personazhe të tragjedisë. Personazhe që duket se e kanë hedhur pas krahëve, me tallje e përqeshje, të djeshmen dhe i ndruhen të sotmes duke përcjellë me hap funebër të kaluarën. Po e ardhmja? Ku është fshehur? Ku bëhet e ardhmja?…

Duke lexuar ti thua se kemi aq shumë ngjashmëri aq se mendon se kemi të bëjmë me recidive, se kjo është spiralja e jetës, herë-herë edhe e lirë, që shfaqet përdhunshëm dhe se ashtu përhumbshëm bëhet edhe mbjellëse e një doktrine të largët e me thellësi shpirti. Një herë tjetër mendon se personazhet janë të zgjedhur, se vënë dhe heqin paruke, se bëhen papritur aq të ngjitur, se i ngjajnë dikujt që është pranë teje, përditshëm, kur situatat komike i kthen në tragjike, natyrisht që dalin nga manteli që i hapen paksa monumentit te sheshi i madh. Të duket se këlyshët do të bëhen qenë e duke u kacafytur për fron dhe ky fron është pranë teje i kredhur në gjak. Populli ecën në rrugë në çdo situatë, ndizet, fle, punon, heshtet, këndon dhe gjithë i përfytyruar, i kudondodhur, i palodhshëm, me besimin e verbër që të çon në skllavëri, populli që përdoret i ndarë dhe që frymon kurdoherë bashkë, i tërhequr ngadalë në skaje të vështira ku ndihet dhe duket përplasja, ku forca që do të pjellë të mirën dhe të keqen dhe ndërkaq liria herë fshihet dhe herë degjeneron prej frikës dhe terrorit. Kështu e shoh të përshkruar situatën në gjendjen e një personazhi të Caymaz-it se ç'do të vijë nesër e pasnesër, duke rrjedhur bashkë me ujërat e smeraldtë të shpirtrave të vetmuar e të braktisur, te Thjeshtra apo te Vajza, apo tek modeli që dashuron dhe i kthehet e gjitha në një Asgjë të madhe teksa diku tjetër profetizohet kalvari që heq e vuan njeriu i shkretë. Këtyre njerëzve duket se u ka ardhur fatura e nderit dhe ata s'kanë rrugë tjetër veçse ta paguajnë. Janë pikërisht ata që shërbehen dhe kërkojnë falje, që tërhiqen, të paktën për një çast, që ndërtojnë edhe një histori biblike, një histori me një plak, një profet, që vjen i pari, që do dhe kërkon me një magji të pashoqe diçka se e ka lënë e dashura dikur. Jo, duhet të dashurosh përsëri. Dhe i vjen ndërmend se kështu fiton jetën dyfish dhe më i plotësuar…

Dhe e ke përherë pranë mentalitetin e heronjve të tregimeve. Aty është mendimi edhe i liderit dhe edhe i asaj që me pa të drejtë këtillohet si fundërrinë. Nga ky duhet pasur frikë. Dëgjoni: në Greqinë e lashtë, në Athinë… Por le ta lëmë më mirë, se po t'i ktheheshim lashtësisë do humbiste edhe e djeshmja edhe e sotmja dhe s'do gjenim vend për të ardhmen…/*Exlibris*






Sport




# Dushku: Çasti i duhur për krijimin e Përfaqësueses A të Femrave

"Mendoj se është çasti i duhur për krijimin e Përfaqësueses A të Femrave. Pra, është një rast shumë i mirë që në vitin 2021 dhe 2022 për dy vjet radhazi do të organizohet FIBA Kampionati Evropian për shtetet e vogla, pasi dihet se kjo garë organizohet për çdo dy vjet por që, për shkak të pandemisë, sivjet është anuluar dhe tani do të organizohet për dy vjet radhazi", ka thënë Elvira Dushku



Prishtinë, 22 qershor - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) që nga anëtarësimi në FIBA në vitin 2015 rregullisht ka marrë pjesë me Përfaqësuese të Reja në FIBA Kampionate Evropiane dhe me Përfaqësuesen A - Meshkujt në garat parakualifikuese dhe kualifikuese për Eurobasket apo FIBA Kupën e Botës.

FBK-ja në vitin 2016 ishte prezantuar në garat zyrtare të FIBA-s me Përfaqësuesen U16 dhe U18 në konkurrencën e femrave në FIBA Kampionate Evropiane në Divizion C. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe në vitin 2017, kurse më 2018 dhe 2019 ka filluar të garojë në një nivel më lartë, pra në Divizion B, derisa në vitin e kaluar për herë të parë FBK-ja ka garuar edhe në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B, në konkurrencën e femrave, garë të cilën edhe e ka organizuar me mjaft sukses në Prishtinë.

Në vitin 2020 FBK i pati paraqitur për të garuar Përfaqësuesen U16 dhe U20-Femrat por që, për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19, FIBA i ka anuluar të gjitha Kampionatet Evropiane të parapara të organizohen gjatë kësaj vere.

Këtë vit ka qenë në program edhe organizimi i FIBA Kampionatit Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në Qipro, e që është shtyrë për vitin e ardhshëm, më saktësisht më 15-20 qershor 2021. "Mendoj se është momenti i duhur për krijimin e Përfaqësueses A të Femrave. Pra, është një rast shumë i mirë që në vitin 2021 dhe 2022 për dy vjet radhazi do të organizohet FIBA Kampionati Evropian për shtetet e vogla, pasi dihet se kjo garë organizohet për çdo dy vjet por që, për shkak të pandemisë, sivjet është anuluar dhe tani do të organizohet për dy vjet radhazi. Ne si FBK duhet ta shfrytëzojmë këtë çast dhe ta fillojmë ndërtimin e Përfaqësueses A të Femrave që nga kjo verë, pavarësisht se ky Kampionat Evropian do të organizohet në verën e ardhshme. Ne planifikojmë të kërkojmë përkrahje financiare për këtë vit nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës në mënyrë që të fillojmë me ndërtimin e ekipit që nga kjo verë. Por së pari ky propozim duhet të miratohet në Bordin e FBK-së, ku do të diskutohet më pas se, edhe me cilat përfaqësuese të reja të femrave do të garojmë në FIBA Kampionate Evropiane në vitin e ardhshëm. Besoj se për gjeneratën e pasluftës do të ishte nder dhe krenari që ta përfaqësonin Kosovën A - Femrat në një garë zyrtare, por edhe për basketbollistet e reja e të talentuara, pra do të ishte një kombinim mjaft i mirë i dy gjeneratave", ka thënë Elvira Dushku, sekretareshë e përgjithshme e FBK-së.

Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

# Sot vendoset kampioni në Superligën e femrave



Prishtinë, 22 qershor - Sot (e martë) do të vendoset kampioni i Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave për edicionin 2019\2020. Në ndeshjen e dytë finale të plejofit do të takohen Istogu dhe Ferizaj. Ndeshja luhet nga ora 18:00 në palestrën "Dresha" në Orroberdë të Istogut. Ndeshjen e parë finale e ka fituar Ferizaj me pesë gola dallim, 34:29. Ndeshja e parë finale e plejofit është luajtur të shtunën në Ferizaj. Madje ferizajaset kishin epërsi edhe më të lartë gjatë ndeshjes, por istogaset u afruan në fund. Ndeshja e dytë dhe vendimtare pritet të jetë me rivalitet. Kampioni aktual, Istogu, synon fitore me më shumë se pesë gola dallim për ta mbrojtur titullin. Ndërsa Ferizaj synon ta mbrojë rezultatin e ndeshjes së parë. Ferizaj për herë të parë garon në Superligë dhe tani ka pretendime për ta fituar titullin. Ferizaj ka lojtarë me përvojë, por përvoja nuk iu mungon as lojtareve të Istogut. Ndeshja do të luhet pa praninë e shikuesve në palestër dhe duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Në gjysmëfinale të plejofit, Istogu e eliminoi Prishtinën, kurse Ferizaj me përmbysje të madhe në ndeshjen e dytë eliminoi Vushtrrinë.

## Liburni - Mabetex Prishtina, finalja e Superligës në futsall



Prishtinë, 22 qershor - Mabetex Prishtina dhe Liburni do të luajnë në finalen e "play-off"-it të Superligës së Kosovës në futsall. Në ndeshjet gjysmëfinale të cilat u zhvilluan gjatë fundjavës që shkoi në Ferizaj pa praninë e tifozëve, Mabetex Prishtina, shënoi fitore në duel me rivalen lokale, Prishtina 01, me rezultat 3:2, kurse Liburni u tregua bindës ndaj Pejës, duke e mposhtur me rezultat 8:0. Ndeshja finale është paraparë të zhvillohet më 27 qershor në Ferizaj teksa skuadra kampione do ta përfaqësojë vendin tonë në garat e Ligës së Kampionëve në futsall.

## Kololli dhe Emini në formacionin e javës në Zvicër

Luzern, 22 qershor - Futbolli zviceran është rikthyer në aksion pas tre muajve pauzë për shkak të pandemisë Covid-19. Në xhiron e 24-të janë regjistruar disa rezultate befasuese si humbja e Baselit në udhëtim te Luzerni 2-1. Kampioni në fuqi, Young Boys Bern, ka marrë fitore 3-2 në shtëpi ndaj Zurichut, ndërsa edhe lideri St Gallen ka triumfuar 1-2 në udhëtim te Sioni. Në formacionin më të mirë të javës janë përfshirë dy futbollistë nga Kosova. Benjamin Kololli ishte fantastik te Zurichu, ku asistoi në golin e parë dhe shënoi golin e dytë nga një distancë prej 30 metrave. Ndërkohë te Luzerni, talenti i madh Lorik Emini ka qenë fantastik në duel me Baselin. 20-vjeçari ka dominuar në mesfushë duke fituar shumë duele dhe në fund është vlerësuar duke u futur në formacionin më të mirë të javës. Formacioni i javës së 24-të: Baumann, Knezeviq, Lucas, Hefti, Araz, Lorik Emini, Benjamin Kololli, Nsame, Itten, Sulejmani, Nuzzolo.



# Dedaj: Në Kosovë nuk mposhtemi nga Mali i Zi e Rumania

Prishtinë, 22 qershor - Me interesim shortin e kualifikimeve për "Euro 2022" e ka përcjellë edhe kapiteni i përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Valon Dedaj. Hendbollisti që karrierën e zhvillon në Zvicër, ka thënë se Kosova është në grup të fortë, por mundësinë janë që të kualifikohet në "Euro 2022". Të kujtojmë që shorti është tërhequr më 16 qershor, kurse Kosova është në grupin e tetë së bashku me Suedinë, Malin e Zi dhe Rumaninë. Dy të parët në të gjitha tetë grupet dhe katër prej tetë kombëtareve të renditura në vendin e tretë, kualifikohen në Evropian. Kombëtarja jonë e kërkon rastin prej pozitës së tretë. "Grupi ynë është shumë i fortë, por duke parë angazhimin e djemve tanë, duhet të jemi optimistë së paku për vendin e tretë në grup. Kualifikimi është i mundur edhe prej vendit të tretë në grup. Do të kemi vështirësi me Suedinë, por Malin e Zi dhe Rumaninë nuk do t'i lejojmë të marrin fitore në Kosovë. Shpresoj dhe duhet të jemi optimistë së paku për vendin e tretë në grup", ka thënë Dedaj.
Kosova ndeshjen e parë e luan më 4 apo 5 nëntor ndaj Malit të Zi në Podgoricë.




# Rritja e rasteve me Covid-19 në Orlando shqetëson klubet e NBA-së

Orlando, 22 qershor - Nga dita e martë të gjitha ekipet e NBA-së që do të vijojnë garën për titullin kampion (22 të tilla nga 30) mund t'i rinisin përgatitjet. Sipas protokollit të sigurisë të miratuar, mund të stërviten vetëm katër lojtarë njëkohësisht dhe stërvitjet do të jenë individuale. Kjo situatë do të zgjasë një javë: 23-30 qershor. Nga 1 korriku mund të stërviten tetë lojtarë, njëkohësisht në qendrat stërvitore të skuadrave (+2 trajnerë) deri më 9 korrik, datë kur ekipet do të zbarkojnë në Orlando. Në qytetin që ndodhet në Florida do të grumbullohen të gjitha ekipet dhe do të vijojnë aty fazën përgatitore, deri më 30 korrik, kur rinisin ndeshjet. Gjithsesi, situata nuk duket e qetë në Orlando. Në shtetin e Floridas javën e kaluar janë regjistruar një numër në rritje i personave të infektuar me Covid-19. Kjo ka rritur panikun te NBA-ja, sidomos te lojtarët e trajnerët, që do të udhëtojnë aty. Kjo ka bërë që ekipi kanadez i Torontos ta shtyjë vajtjen në Orlando me disa ditë, ndërkohë që ekipet pasi të mbërrijnë do të qëndrojnë në karantinë dhe kryejnë testet.



## SHKURT

### Hysaj, Napolit: Dua të largohem

Mbrojtësi i Napolit, Elseid Hysaj, i është drejtuar klubit me shkresë për t'u larguar sepse nuk është i lumtur se i duhet të garojë për një vend titullari me Giovanni Di Lorenzo. Gazeta e përditshme italiane, "La Gazzetta dello Sport", raporton se 26-vjeçari ka dorëzuar kërkesën për largim nga klubi verë. Hysaj iu bashkua Napolit nga Empoli në vitin 2015 për 5 milionë euro dhe i ka zhvilluar plot 187 ndeshje për të kaltrit që prej atëherë.

### Bayerni planifikon huazimin e Dajakut në Holandë

Bayern Muncheni po planifikon huazimin e Leon Dajakut në një tjetër klub tjetër për të fituar përvojë. "Sport1" raporton se klubi gjerman është duke e kërkuar një destinacion për sezonin e ardhshëm për 19-vjeçarin me prejardhje nga Kosova. Utrecht, një klub holandez që luan në Eredivisie, ka shprehur interesim për Dajakun e, po ashtu, edhe disa skuadra të nivelit të mesëm në Bundesligë, emrat e të cilëve mbesin sekret.

### Dy tenistë rezultojnë pozitivë me Covid-19

Duhet të ishte turneu që do ta konfirmonte tenisin si një nga sportet më të sigurta sa i përket përhapjes së koronavirusit, por në të vërtetë është kthyer në një "bombë biologjike". Pas Grigor Dimitrov, edhe Borna Coriç ka zyrtarizuar personalisht se është pozitiv me Covid-19. Tenisti kroat, ashtu si edhe ai bullgar, janë infektuar gjatë turneut "Adria Tour", ku merrte pjesë edhe Novak Djokoviçi. Nga 22 pjesëmarrësit e "Adria Tour" që iu nënshtruan testit me tamponë, tre rezultuan pozitivë, dy tenistët e lartpërmendur dhe një prej trajnerëve. Sa i përket Djokoviqit, ai pritet të kryejë një tjetër test në Beograd, për të mësuar nëse është prekur apo jo nga Covid-19.

### Bailey drejt largimit nga Leverkuseni

Leon Bailey ka kaluar një sezon të vështirë me Bayer Leverkusenin. Mes dëmtimeve, pezullimeve dhe qëndrimit në stol, e ardhmja e sulmuesit xhamajkan është larg "aspirinave" dhe admiruesit e tij më të mëdhenj janë në Premierë Ligë. Ekipi është me një këmbë jashtë Ligës së Kampionëve, çka mund ta sjellë largimin e disa lojtarëve, ku mes tyre pritet të jetë edhe sulmuesi 22-vjeçar, i cili ndiqet nga Manchester United, Chelsea dhe Milani.

### Immobile refuzon Newcastelin

Sulmuesi Ciro Immobile është shumë pranë rinovimit me Lazion, duke refuzuar në këtë mënyrë ofertën e Newcastles. Sulmuesi pritet ta zgjasë kontratën me ekipin italian deri në vitin 2025. "Tuttosport" raporton se Immobile ka rënë dakord me kushtet paraprake në kontratë ku do të përfitojë 4 milionë euro në vit. Sulmuesi italian ka shënuar 27 gola në 26 ndeshje të Serisë A, ndërkohë që Lazio renditet e dytë në kampionat dhe si asnjëherë më parë kanë shpresa për ta fituar titullin. Gazeta italiane pretendon se Immobile dëshiron të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve me Lazion, ndaj dhe ky është një faktor që e ka nxitur që t'i refuzojë ofertat e ardhura nga klubet e tjera evropiane.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKE I TEHNOLOGIJU

**QENDRA E STUDENTËVE E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS PRISHTINË**
**STUDENTS' CENTER OF UNIVERSITY OF PRISHTINA PRISHTINA**
**STUDENTSKI CENTAR UNIVERSITETA PRISHTINE PRISHTINA**

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel:. +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
web: www.qendraestudenteve.com

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212,neni 7 dhe 8 të Ligjit të Punës , të Republikës të Kosovës,publikon këtë :

# K O N K U R S

**Titulli i postit:** **1. (Një) Ndezës i kazanave me avull**
**Sektori :** **Sektori per IT dhe Shërbime Logjistike**
**Kontrat :** **Me afat te caktuar**
**Raporton te:** **Udheheqesi i Sektorit për teknologji informative dhe logjistik**
**Koeficienti:** **6.5**

**Detyrat kryesore:**
- Kujdeset mbi funksionimin normal të të gjitha stabilimenteve në ngrohtore dhe nënstacione të Qendrës
- Kryen përmirësimet në stabilimentet e ngrohtores dhe në instalimin e të gjitha pajisjeve për ngrohje në konvikte restaurant etje.
- Është përgjegjës për aparate kundër zjarrit ne ngrohtore.
- Kujdeset për ndërrimin e bocave të plinit
- Me kohë lajëmron udhëheqësit mbi gjendjen e rezervave të lendëve djegëse ose naftës se rezervuar.
- Kryen dhe punë tjera salarium me aparat dhe autogen
- Kryen dhe punë tjera sipas urdhërit të udhëheqsit të shërbimit teknik

**Aftësitë:**
- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioriteteve të punës dhe shkathtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e strehimit
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë informative në konvikte

**Kualifikimi dhe përvoja:**
- shkolla e mesme
- së paku 1 (Nje) vjet përvojë pune

**Titulli i postit:** **1. (Një) - Shtëpiak**
**Drejtori :** **Drejtoria për Strehim**
**Kontrat :** **Me afat te caktuar**
**Raporton te:** **Udheheqesi i Sektorit**
**Koeficienti:** **6.**

**Detyrat kryesore:**
- Rregullon bravat e dyerve ,dritareve të konviktit
- Mban dhe largon defektet vijuse të kanalizimit,ujësjellësit dhe rrjetit elektrik
- Lajmron udhëheqsin e shërbimit teknik dhe zyrtarin e pagesave për prishjet e mdha dhe për ato të cilat vet nuk mund ti evitoj
- Sipas nevojës ju ndihmon punëtorve tjer gjatë kryerjes së punve në rastet e shtimit të vëllimit të punve
- Sipas nevojës kryen edhe punë me ndrrime ,sipas urdhërit të udhëheqësit të konviktit
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të udhëheqësit të strehimit dhe drejtorit

**Aftësitë:**
- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioriteteve të punës dhe shkathtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e strehimit
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë informative në konvikte

**Kualifikimi dhe përvoja:**
- shkolla e mesme
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune
- e Kosovës .

# K O N K U R S

**Titulli i postit:** **1 punëtor/e në kuzhinë-Servues/e**
**Shërbimi:** **Ushqimit**
**Vendimi:** **(Me afat te caktuar)**
**Raporton te:** **Drejtori i mensës dhe restorantit,**
**Koeficienti:** **5.**

**Detyrat kryesore:**
- Bënë distribuimin e ushqimit në vija për shërbim l sipas udhëzimit të përgjegjësit të ndërrimit
- Kujdeset mbi shfrytëzimin racional dhe ruajtjen e pajisjeve dhe stabilimenteve
- Bënë përgatitjen e patateve, sallatave,komploteve e të
- Kujdeset mbi disiplinën e punës në linja të shërbimit
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të kryepunëtorit të ndërrimit dhe udhëheqësit të kuzhinës

**Aftësitë:**
- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioriteteve të punës dhe shkathtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë së ushqimit

**Kualifikimi dhe përvoja:**
- shkolla e mesme
- së paku 1 (një) vjet përvojë pune.

**Titulli i postit: 3. Punëtor/e në kuzhinë-Enëlarës/e**
**Drejtoria:** **Ushqimit**
**Vendimi:** **Me afat te caktuar**
**Raporton te:** **Drejtori i t ushqimit**
**Koeficienti:** **5.**

**Detyrat kryesore:**
- Është përgjegjës për mënyrën e përdorimit të rregullt të makinës për larjen e enëve dhe për punën e saj normale
- Është i obliguar që ti ndihmoj banakierit gjatë pranimit të enëve
- Ndan inventarin sipas llojit dhe vendos në makinë për larje
- Kujdeset për mirëmbajtjen e rregullt të makinës dhe higjenës së saj
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të kryepunëtorit të ndërrimit dhe udhëheqësit të kuzhinës

**Aftësitë:**
- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioriteteve të punës dhe shkathtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë së ushqimit

**Kualifikimi dhe përvoja:**
- shkolla e mesme
- së paku 1 (një) vjet përvojë pune

**Informacionet plotësuese:**
- Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore.
- aplikacionet merren /dorëzohen (bashkangjitur të gjitha dokumentet relevante në kopje) në Qendrën e studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, rruga Agim Ramadani, p.n. kati i dytë, nr. kontaktues i telefonit 038-223-951, prej orës 08,oo – 16,oo,
- aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohej aplikacionet e pakompletuara mund të refuzohen
- kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen përmes telefonit.

Qendra e studentëve është në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha komunitetet e Kosovës.

# K O N K U R S

**Naslov posta:: 1 (jedan) Lozac parnog kotla**

**Sluza: Tecnicka**
**ugovor: Postavlejni rok**
**Izveštaji: načelnik Sektora za informacione tehnologije koje odražava i logistiku**
**Koeficijent: 6.5**

**Glavni zadaci:**
- Stara se o normalnom funkcionisanju svih toplotnih uredaja I postanica u centru
- Vrsi nadogradnju toplotnih uredaja I instalaciju svih uredaja ze grejanje u domovima, restoranu,itd.,
- Odgovoran je za protivpozarne,aparate u toplontoj podstanici.
- Stara se o zameni plinckih boca
- Blagvoremeno upozanje rukovodioca o postojacem stanju I rezervama cvrstih goriva ili nafte u rezervoaru.
-obavalja I druge poslove na zavarivanju apartom za autego zavarivanje.
-Obvalja I druge poslove shodno nalogu rukovodioca tehnice sluzbe.

**Veštine:**
- Dobre komunikacione veštine.
- spremnost da rade sa malom nadzor
- Dobre interpersonalne veštine i drži u kontaktu sa onima koji su odlukom
- sposobnost za određivanje prioriteta rada i upravljanja vreme veštine.
- obavezno priznavanje službenih jezika u upotrebi.
- poznavanje engleskog jezika je prednost.
- nadzire rad i aktivnosti u oblasti stanovanja
- nadzire rad i aktivnosti u oblasti informacionih tehnologija u domovima

**Kvalifikacije i iskustvo:**
- srednje škole
- najmanje 1(Jedan) godina radnog iskustva

**Naslov posta:: 1 (jedan) domaćinstvo**
**Direktor: Direkcija za finansije i opšte usluge**
**ugovor: Dy (Dve godina)**
**Izveštaji: načelnik Sektora za informacione tehnologije koje odražava i logistiku**
**Koeficijent: 6.**

**Glavni zadaci:**
- Podesite brave, prozori ukrcavanje
- Održava i otklanja nedostatke dalje sledeće kanalizacije, vode i električnu mrežu
- Lideri objavljuje zvaničnu tehničku službu i plaćanje za veće propuste i onih koji ne mogu zaobići njegov
- Ako je potrebno, da ti pomognem dok obavlja druge radnike rad u slučajevima dodaje zapremine rad
- Ako je potrebno, nastupa sa smenama, redosled šefa boarding
- obavlja i druge poslove po nalogu šefa stanovanja i direktora

**Veštine:**
- Dobre komunikacione veštine.
- spremnost da rade sa malom nadzor
- Dobre interpersonalne veštine i drži u kontaktu sa onima koji su odlukom
- sposobnost za određivanje prioriteta rada i upravljanja vreme veštine.
- obavezno priznavanje službenih jezika u upotrebi.
- poznavanje engleskog jezika je prednost.
- nadzire rad i aktivnosti u oblasti stanovanja
- nadzire rad i aktivnosti u oblasti informacionih tehnologija u domovima

**• Kvalifikacije i iskustvo:**
- srednje škole
- Najmanje 2 (dve) godine radnog iskustva

**Dodatne informacije:**
- Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana njegovog objavljivanja u jednim od dnevnih novina.
- Prijave za konkurs se uzimaju i predaju (zajedno sa kopijama svih relevantnih dokumenata) u Studentskom centru Univerziteta u Prištini, Priština, u ulici Agima Ramadanija bez broja, drugi sprat, broj telefona za kontakt 038-223-951, od 08,00 – 16,00,
- Prijave na konkurs podnete po isteku poslednjeg dana neće biti prihvaćene.
- Nepotpune prijave na konkurs mogu da budu odbijene.
- Kandidati koji uđu u uži izbor biće pozvani na razgovor telefonom.
- Studentski centar je u službi svih građana i pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje pripadnicima svih zajednica na Kosovu.

**Naziv pozicije:** **1.Uslužitelj obroka**
**Usluga:** **Hrana**
**Trajanje ugovora:** **1 (jednogodišnji)**
**Izveštava:** **Direktor Centra**
**Koeficijent:** **5.**

**Glavni zadaci:**
- Vrši distribuciju obroka po linijama za uslugu prema instrukcijama glavnog radnika smene
- Brine se o racionalnoj upotrebi obroka i čuvanju opreme
- Vrši pripremu kompira, salata i dezerta
- Brine se o dsciplini rada u linijama za uslugu
- Vrši ostale dužnosti prema instrukcijama glavnog radnika smene i rukovodstva kuhinje

**Veštine:**
- Dobra sposobnost komunikacije
- Sposobnost vršenja dužnosti bez nadgledanja
- Dobre među-personalne sposobnosti i održavanje kontakata sa rukovođstvom
- Sposobnost za određivanje radnih prioriteta i menadžment vremena
- Obavezno poznavanje zvaničnih jezika u upotrebi
- Poznavanje engleskog jezika je prednost
- Nadgleda rad i aktivnosti u oblasti tehnologije hrane.

**Kvalifikacije i iskustvo:**
- Srednja a škola
- Najmanje 1 (Jedan) godine profesionalnog iskustva u oblasti tehnologije ishrane.

**Naziv položaja:** **3/ Sudoper/ra**
**Služba:** **Ishane**
**Ugovor:** **1 (jednogodišnji)**
**Izveštava kod:** **Rukovodioca Službe ishrane**
**Koeficijent: 5.**

**Glavni zadaci:**
- Odgovoran je za način redovne upotrebe mašine za pranje sudova i za njen normalan rad
- Obavezan je da pomaže šankistu za vreme prijema sudova
- Deli inventar prema vrsti i postavlja u mašinu za pranje sudova
- Brine se za redovno održavanje mašine za pranje sudova i njenu higjienu
- Obavlja i druge poslove po naredbi glavnog šefa smene i rukovodioca kuhinje .

**Sposobnosti:**
- Dobre sposobnosti komuniciranja
- Spremnost da deluje sa malim nadzorom
- Dobre međuljudske sposobnosti i održavanje kontakata sa osobama odlučivanja
- Sposobnosti za utvrđivanje prioriteta posla i snalažljivosti za menađiranje vremena
- Obavezno poznavanje službenih jezika koji su u upotrebi
- Poznavanje engleskog vezika je prednost
- Nadzire rad i aktiavnosti iz oblasti tehnologije ishrane

**Kvalifikacija i iskustvo :**
- Srednja škola
- Najmanje 1(jedan) godine radnog iskustva

**Dopunske informacije:**
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.
- Aplikacije se uzimaju/predaju (uz priložene kopije svih potrebnih dokumenata) u Studentskom centru prištinskog univerziteta u Prištini, ul. Agim Ramadani, bb. II sprat, broj kontakt telefona 038-223-951, od 08,oo – 16,oo.časova
- Aplikacije koje su dostavljene nakon isteka roka neće biti primljene,
- Ne kompletirane aplikacije mogu biti vraćene.
- Kandidati koji budu selektirani u užu listu za intervjuisanje, biće naknadno informisani telefonom.
- Studentski centar je u službi svih građana i pruža jednake mogućnosti zapošljavanja pripadnicima svih zajednica na Kosovu.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Ex Fis” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Dragodan komuna e Prishtinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Hotel Rio” rruga M-2 pn, në Dragodan komuna e Prishtinës do të organizohet debat publik nga kompania “Ex Fis” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Dragodan komuna e Prishtinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Ex Fis” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.07.2020 në ora 13:00 në hapësirat e restorant “Vicianum” rruga “Analin” pn, në Vushtrri do të organizohet debat publik nga kompania “Ex Fis” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Vushtrri.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Pura Prodest” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810121484, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pura Prodest” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 810121484 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Pura Prodest ” L.L.C, , has come to the decision to quit its business: 810121484 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Nazmije Bucko shpall te pavlefshme dipllomen shme " Ymer Prizreni "Prizren

▶ Mehmet Veliu shpall te pavlefshme dipllomen shmlt "11 Marsi " Prizren

▶ Almir Ademaj shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Remzi Ademaj " Zhur

▶ Njomza Rramanaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shf " Naim Frasheri " Kobaje

▶ Sebahate Haziri shpall të pavlefshme licencën e punës nr. KO-0797-05-01 Prishtinë.

▶ Lëshoj banes me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
**06-Nr- 989**
**Me datë 23.06.2020**

Në bazë të nenit 13.dhe 58,Të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr- 03/L-040, neni 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01.Nr-016.-8336 të datës 04.11.2008,e në mbështetje të nenit 44,lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr.05/L-031,për Procedurën e Përgjithshme Administrative,,Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,Nr-20/2016,Kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale 06.Nr.917 të datës 09.06.2020 dhe Autorizimit të Kryetarit të Komunës , Drejtoria shpallë këtë:

**KONKURS**

1.**Një mjek**/e të praktikës së përgjithshme të QKMF-së në Suharekë.

**Numri i Referencës: 06- Nr. 989**

**Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :**
- Kujdeset për shëndetin e pacientëve,përshkruan tretmanet,medikamentet dhe aplikon masat tjera shëruese;
- Udhëzon pacientët në bërjen e analizave bazike laboratorike dhe aplikon procedurat tjera diagnostike;
- Aranzhon bartjen e pacientëve në spital;
- Udhëzon pacientët tek specialistët mjekësor dhe shkëmben të dhënat relevente mjekësore;
- Pranon implimentimin e programeve shëndetësore të dizajnuara në nivele më të larta si Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna;
- Ndihmon në preventimin e sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve të ndryshme duke u këshilluar në shëndetin bazik të përgjithshëm etj.

Kualifikimi : Të gjithë kandidatët duhet të kenë të kryer fakultetin e Mjekësisë,drejtimi i Mjekësisë së përgjithshme.
- Orari i punës: I plot;
- Paga: H-27,H-565/1
- Kohëzgjatja 6 gjasht muaj punë me mundësi vazhdimi

**Kandidatët që aplikojnë duhet të sjellin këto dokumente;**
- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer:
- Vërtetimin mbi stazhin e kryer;
- Licencën e punës;
- Çertifikatën e lindjës;
- Fotokopjën e letërnjoftimit;
- Çertifikatën e gjendjës shëndetësore.
- Çertifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në Suharekë.
**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.**

**Drejtori i Drejtorisë për**
**Shëndetësi dhe M.Sociale**
**Ma.Sc.Besa KUQI**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
**06-Nr- 989**
**Me datë 23.06.2020**

Në bazë të nenit 8 të pika 1 dhev 2 Ligjit të punës Nr- 03/L-212 dhe sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës , Drejtoresha e Drejtorisë shpallë këtë:

**KONKURS**

1. Një teknik/e medicinal në QKMF-së në Suharekë me kohë të pa caktuar

**Numri i Referencës: 06- Nr- 989**

**Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :**

- Të ofroj ndihmën e parë dhe kujdesin tekniko fizik për pacientët
- Të kryej punë dhe detyra të punës sipas urdhërit të drejtorit
-Kandidati duhet të ketë të kryer shkollën e mesme të mjekësisë;
-E obligueshme: Kryerja e praktikës profesionele- stazhi 6 mujor, e preferuar përvoja e punës 1 vjeçare si infermier/e .
**Orari i Plotë:**
**Paga mujore bruto: H-68,H-377/1**
**Kohëzgjatje e kontratës : Gjasht muaj punë provuese me mundësi vazhdimi**

-Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer
-Vertetimin mbi praktikën profesionale – përvojën
-Çertifikatën lindjës
- Fotokopjen e Letërnjoftimit
-Çertifikatën e gjendjës shëndetësore
-Licenca e punës
- Certifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato qe arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë te Parku i qytetit në Suharekë.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.**

**Drejtori i Drejtorisë për**
**Shëndetësi dhe M.Sociale**
**Ma.Sc. Besa KUQI**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit**
**06. Br. 989**
**Datum: 23.06.2020**
Na osnovu člana 13 i i58,Zakona o Lokalne Samouprave br.-03-L040, člana 30 i 45 Statuta Skupstine Opstine Suve Reke 01.Br.-016-8336 datuma 04.11.2008,i na osnovu člana 44, u vezi člana 49, Zakona Br-05-031, za O.U.P,Zvanične Novine Kosovske Republike, Br.-20/2016,zahteva OCPM 06.Br.917.datuna : 09.06.2020 i Ovlaščenjem Predsednika Opštine, Direkcija objavljuje sledeći:

**KONKURS**

**1. Jedan lekar** opšte prakse za potrebe OCPM u Suvoj Reci
Naznaka broj: **06- Br. 989**

**Opis poslova i radnih obaveza:**
- Stara se o zdravlju,opisuje tretmane, lekove, i preuzima ostale mere za zdravstvenu negu pacijenata;
- Upućuje pacijente na osnovu laboratoriske analize i primenjuje ostale dijagnoštike procedure;
- Organizuje prenos pacijenata u bolnicu;
- Upućuje pacijente kod lekara specijaliste i razmenjuje relevantne medicinske podatke;
- Prihvata sprovođenje zdravstvenih programa sastavljenih na višim nivoima, kao Ministarstvo Zdravlja i Opštine;
- Pomaže u prevenciji zarazne bolesti i razne poremećaje u skladu sa osnovama opšteg zdravstevenog stanja itd.
- **Kvalifikacije**: Svi kandidati moraju imati završen Medicinski Fakultet – smer Opšte Prakse;
- Puno radno vreme ;
- Plata : H-27,H-565/1
- Trajanje ugovora : 6 meseci probno sa mogućnosti produženja.

**- Kandidati koji konkurišu moraju doneti sledeću dokumentaciju :**
-Diplomu o stručnom obrazovanju;
-Potvrdu da je završio/la praksu;
-Licencu za rad;
-Izvod rođenih;
- Fotokopiju lične karte
-Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrdu da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.

Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanje svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i ženskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.
Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispele po isteku roka, neće biti razmatrane.
Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkciji za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit u Suvoj Reci.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim sredstvima javnog informisanja.**

**Direktor Direkcije, OCPM**
**Ma.Sc. Besa KUQI**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit**
**06. Br. 989**
**Datum: 23.06.2020**

Na osnovu člana 8 stav 1 i 2 Zakona o radu Br-03/L-212 , i ovlašćenjem Predsednika opštine, Direktor Direkcije objavljuje sledeći:

**KONKURS**

1.Jedan medicinski tehničar/ka u OCPM u Suvoj Reci.
Naznaka broj: **06- Nr- 989**
Opis poslova i radnih obaveza:
- Da pruža prvu pomoć i vodi brigu o tehničko - fizičkom zbrinjavanju pacijenata.
- Da obavlja poslove i radne zadatke po nalogu direktora.

Kandidat mora imati završenu srednju medicinsku školu;
Obavezno je: da je obavljao stručnu praksu u trajanju od 6 meseci, poželjno je da ima 1.godišnje iskustvo u radu kao medicinski tehničar/ka
Puno radno vreme:
Bruto mesečna plata: H-68, H-**377/1**
Trajanje ugovora: Šest (6) meseci probnog rada sa mogućnošću produženja.
Kandidati koji konkurišu moraju doneti sledeću dokumentaciju :
-Diploma o stručnom obrazovanju;
-Potvrda da je završio/la praksu;
-Licenca za rad;
-Izvod rođenih;
- Fotokopija lične karte
-Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrda da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.
Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispele po isteku roka, neće biti razmatrane.
Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanje svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i ženskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.
Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj direkciji za zdravstvo u Suvoj Reci.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim sredstvima javnog informisanja.**

**Direktor Direkcije, OCPM**
**Ma.Sc. Besa KUQI**